



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 8 (827812)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 24 shkurt 2023

Vlerësim maksimal për specialistët tanë që krenuan të gjithë popullin shqiptar

Tre skuadrat shqiptare që morën pjesë në operacionet e kërkim - shpëtimit pas dy tërmeteve shkatërrimtare në Turqi, pas 11 ditësh pune intensive, u kthyen ne atdhe. Rreth 85 trupa, në përbërje të të cilëve ishin efektivë të Forcave të Armatosura, të Emergjencave Civile, ekipeve shëndetësore, janë përcjellë me duartrokitje nga përfaqësues të autoriteteve turke, por edhe qytetarë të thjeshtë, të cilët u shprehën mirënjohjen për kontributin e tyre. Momenti i përcje-

lljes së trupave shqiptare është transmetuar edhe nga agjencia turke e lajmeve IHA (Ihlas Haber Agency). Në ceremoninë e përcjelljes ishte e pranishme edhe konsullja shqiptare në Stamboll, Blerta Kadzadej, e cila shprehu falënderimet për punën e palodhur të ekipëve shqiptare. Koloneli Elton Reso tha se përgjatë këtyre ditëve të kërkim-shpëtimit janë nxjerrë nga ekipet shqiptare 26 persona të bllokuar nën rrënoja, mes të cilëve edhe disa të mbijetuar. Ai kujton sa emocionues

ishte momentin kur nga rrënojat u nxor një vajzë e vogël. Ekipet shqiptare në koordinim edhe me emergjencat turke, AFAD u vendosën kryesisht në zonën e Malatyas. Shqipëria iu përgjigj menjëherë thirrjes për ndihmë të Turqisë dhe brenda 24 orëve në zonat e tërmetit mbërriti ekipi i parë shqiptar i shpëtimit. Gjithashtu, në emër të popullit shqiptar, Kryeministri i vendit Edi Rama u bë pjesë e fushatës ndërgjegjësuese, duke dhuruar 1 milion... >>> faqe 2



Ministri Peleshi: Qeveria shqiptare, trajtim me paga konkurruese në tregun privat dhe atë rajonal



Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim atasheun ushtarak të BE-së, kolonel Pietro Mostardi

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim atasheun ushtarak të Bashkimit Evropian, kolonel Pietro Mostardi (jo-rezident në Shqipëri). Gjeneral brigade Kingji u shpreh se ky takim është një mundësi e mirë për të diskutuar nga afër çështje në interes të përbashkët në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Kontributi i Shqipërisë në misionet dhe operacionet në kuadër të NATO-s janë një shembull mjaft i mirë për të shërbyer më tej bashkëpunimit në të ardhmen për pjesëmarrjen e FARSH-së në operacione dhe misione të drejtuara nga BE...



>>> Faqe 2

Forca Tokësore nis kontingjentin e KFOR-3 në kuadër të misionit KFOR, Pejë, Kosovë

Në ambientet e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave nga batalioni i Dytë i Këmbësorisë (b2k), të cilët do të shërbejnë në KFOR, si pjesë e misionit të NATO-s, në Pejë, Kosovë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë: zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, miq dhe familjarë të efektivave të kontingjentit paqeruajtës etj. Fjala e hapjes u mbajt nga komandanti i b2k-së, nënkolonel Agim Kuçana, i cili...



>>> Faqe 4

75 vjet CISM: "Miqësi nëpërmjet sportit - Friendship through sport"

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Sporteve Ushtarake (CISM), në të gjitha komandat e Forcave Mbështetëse dhe strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të RSH, u zhvilluan aktivitete të shumëllojshme sportive në nder të festimeve të "International Day of Military Sports 2023", nën moton "Miqësi nëpërmjet sportit". FARSH, në Komandat e Forcave/Mbështetëse dhe strukturat e tjera në vend dislokimit e tyre në këtë përvjetor ndërkombëtar sportiv, kanë marrë pjesë me rreth 3000 efektivë, të cilët u aktivizuan me një...



>>> Faqe 6-7

Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim atasheun ushtarak të BE-së, kolonel Pietro Mostardi

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim atasheun ushtarak të Bashkimit Evropian, kolonel Pietro Mostardi (jo-rezident në Shqipëri).

Gjeneral brigade Kingji u shpreh se ky takim është një mundësi e mirë për të diskutuar nga afër çështje në interes të përbashkët në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Kontributi i Shqipërisë në misionet dhe operacionet në kuadër të NATO-s janë një shembull mjaft i mirë për të shërbyer më tej bashkëpunimit në të ardhmen për pjesëmarrjen e FARSH-së në operacione dhe misione të drejtuara nga BE.

Ndër të tjera, gjeneral brigade Kingji riafirmoi qëndrimin e qartë të Shqipërisë në çështjen e Kosovës, si pjesë e interesit tonë kombëtar, në mbështetje të të gjitha aspiratave të saj në anëtarësimin në organizmat ndërkombëtare dhe jo vetëm. Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në rajonin e Ballkanit, duke promovuar paqe, siguri dhe prosperitet.

Atasheu ushtarak i BE-së, kolonel Mostardi e vlerësoi rolin e Shqipërisë, duke e cilësuar atë partner të besueshëm. Do të punojmë së bashku për të gjetur mundësi të reja bashkëpunimi në projekte dhe pjesëmarrje në misione.

Historiku i bashkëpunimit ushtarak me BE-në e ka zanafillën që në vitin 2005, me pjesëmarrjen në misionin MINURCAT, në Çad, në misionin EUTM, në Mali, operacionin detar EUNAVFOR në Somali, misionin EUFOR-ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë.



KLO, vizita në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, Komandën e FT dhe ROS

Në vijim të realizimit të programit mësimor kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, zhvilluan një vizitë njohëse në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, Tiranë.

Stafi akademik dhe grupi mësimor u pritën nga Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Cako, i cili pasi i uroi mirëseardhjen i njohu ata me anë të një brifingu me: misionin, detyrat, pjesëmarrjen në operacione brenda dhe jashtë vendit si dhe rolin që kjo qendër realizon në varësi të vendit dhe llojit të emergjencës.

Më tej vizita vijoi me një sesion pyetje-përgjigje, ku kursantët adresuan pyetje, duke u ndalur tek angazhimet e fundit dhe detyrat në të ardhmen. Shefi i departamentit të operacioneve, kolonel Isuf Hamati dhe kursantët shprehën mirënjohjen për informacionin e ofruar si dhe kontributin që kjo qendër jep në përbashkëpunimin e detyrave në operacionet e E-C brenda dhe jashtë vendit.

Vizita nga afër e kësaj qendre konsolidoi akoma më shumë njohuritë e kursantëve për rolin dhe përgjegjësitë aktuale të saj.

Një tjetër vizitë njohëse në kuadër realizimit të programit mësimor, kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit zhvilluan pranë Kolegjit të Mbrojtjes



dhe Sigurisë në Komandën e Forcës Tokësore dhe Regjimentin e Operacioneve Speciale, Zall-Herr.

Stafi akademik dhe grupi mësimor u pritën nga gjeneral brigade Ferdinand Dimo, zëvendëskomandanti i FT, i cili pasi i uroi mirëseardhjen stafit dhe grupit mësimor të Kursit të Lartë ia dha fjalën kolonel Beqir Tafilit, i cili i njohu ata me misionin, detyrat, pjesëmarrjen në operacione brenda dhe jashtë vendit si dhe projektet e modernizimit që do ndikojnë në përmbushjen e detyrave.

Më tej, vizita vijoi me një sesion pyetje-përgjigje, ku kursantët adresuan pyetje duke u ndalur tek angazhimet e fundit dhe detyrat në të ardhmen. Me shumë interes u prit nga kursantët diskutimet për planet e modernizimit të FT dhe ndryshimet e propozuara për strukturën e aktivizimit të komponentit rezervist. Vizita vijoi në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS) ku u njohën me misionin detyrat, kontributin në operacione dhe planet për të ardhmen për zhvillimin dhe modernizimin e këtij regjimenti.

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Ministri Peleshi: Qeveria shqiptare, trajtim me paga konkurruese në tregun privat dhe atë rajonal

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mbledhi në takim skuadrën e mbrojtjes kibernetike, të punësuar rishtas në Njësinë Ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike pranë Forcave të Armatosura.

“Qeveria shqiptare është e vendosur të afrojë më të mirët e tregut, duke synuar, me anën e trajtimit, trajnimeve dhe pagave shtesë, të jetë konkurruese me tregun privat e pse jo me atë rajonal. Ky është një vit transformimi jo vetëm në nivel burimesh njerëzore për NJUSK por edhe infrastrukturor, falë mbështetjes së aleatit tonë strategjik SHBA, me ngritjen e Qendrës Operacionale për Sigurinë Kibernetike”, - u shpreh gjatë takimit ministri Peleshi.



Ministri Niko Peleshi: Ju falënderoj në emër të ministrisë, qeverisë dhe popullit për përfaqësimin dinjitoz që i bëtë Shqipërisë në këtë mision me risk

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, priti efektivet që u kthyen nga misioni i solidaritetit në zonat e shkatërruara nga tërmeti i 6 shkurtit në kufirin mes Turqisë dhe Sirisë.

Në fjalën e tij, ministri Peleshi shprehu mirënjohjen, në emër të Ministrisë së Mbrojtjes, qeverisë dhe popullit shqiptar, për punën e bërë nga pjesëtarët e ekipeve që u angazhuan në terren që në momentet e para, pas thirrjes së lëshuar për ndihmë nga autoritetet turke dhe Mekanizmi Evropian i Mbrojtjes Civile.

“Ne kemi treguar në histori, e treguam edhe këtë herë me gjestin tuaj, se ne jemi pranë popujve të tjerë në ditë të vështira si ky rast. Unë dua t’ju falënderoj nga zemra në emër të ministrisë, qeverisë dhe popullit, për përfaqësimin dinjitoz që i bëtë Shqipërisë në këtë mision me risk. Sikur, qoftë edhe një jetë kemi mundur të shpëtojmë, nuk ka të paguar”, - u shpreh ministri Peleshi.

Z. Peleshi tha se vlerësimet maksimale për stafin shqiptar ka marrë nga pala turke. “Kemi qenë vendi i parë, që reaguam dhe u ofruam në thirrjen e Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile. Ishte një moment i rëndësishëm për ne,



sepse ishte hera e parë pas anëtarësimit, ku ne u angazhuam për të dhënë kontribut dhe jo për të kërkuar mbështetje. E treguam përmes punës tuaj, sakrificës suaj. Treguam që jemi pjesë e rrjetit të partnerëve të aleancës së madhe, qoftë në NATO, qoftë në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile, jemi edhe për të kontribuar”, - theksoi gjatë pritjes ministri i Mbrojtjes.



Vlerësim maksimal për specialistët tanë që krenuan të gjithë popullin shqiptar

Tre skuadrat shqiptare që morën pjesë në operacionet e kërkim - shpëtimit pas dy tërmeteve shkatërrimtare në Turqi, pas 11 ditësh pune intensive, u kthyen në atdhe.

Rreth 85 trupa, në përbërje të të cilëve ishin efektivet të Forcave të Armatosura, të Emergjencave Civile, ekipeve shëndetësore, janë përcjellë me duartrokitje nga përfaqësues të autoriteteve turke, por edhe qytetarë të thjeshtë, të cilët u shprehën mirënjohjen për kontributin e tyre. Momenti i përcjelljes së trupave shqiptare është transmetuar edhe nga agjencia turke e lajmeve IHA (Ihlas Haber Agency). Në ceremoninë e përcjelljes ishte e pranishme edhe konsullja shqiptare në Stamboll, Blerta Kadzadej, e cila shprehu falënderimet për punën e palodhur të ekipeve shqiptare. Koloneli Elton Reso tha se përgjatë këtyre ditëve të kërkim-shpëtimit janë nxjerrë nga ekipet shqiptare 26 persona të bllokuar nën rrënoja, mes të cilëve edhe disa

të mbijetuar. Ai kujton sa emocionues ishte momenti kur nga rrënojat u nxor një vajzë e vogël. Ekipet shqiptare në koordinim edhe me emergjencat turke, AFAD u vendosën kryesisht në zonën e Malatyas.

Shqipëria iu përgjigj menjëherë thirrjes për ndihmë të Turqisë dhe brenda 24 orëve në zonat e tërmetit mbërriti ekipi i parë shqiptar i shpëtimit. Gjithashtu, në emër të popullit shqiptar, Kryeministri i vendit Edi Rama u bë pjesë e fushatës ndërgjegjësuese, duke dhuruar 1 milion euro në ndihmë të rindërtimit.

Në emër të Presidencës Turke, Ministrisë së Punëve të Jashtme të Turqisë dhe Zyrës së Governorit të Stambollit, Ambasadorja Ayşe Sözen Usluer, për ekipin shqiptar që ndihmoi në operacionet e kërkim-shpëtimit në Malatya, pas tërmetit të 6 shkurtit, u dha ‘Pllaka e mirënjohjes’, e cila u tërhoq nga Konsullja e Shqipërisë në Stamboll, Blerta Kadzadei.



Në ambientet e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave nga batalioni i Dytë i Këmbë-sorisë (b2k), të cilët do të shërbejnë në KFOR, si pjesë e misionit të NATO-s, në Pejë, Kosovë.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë: zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, miq dhe familjarë të efektivave të kontingjentit paqeruajtës etj.

Fjala e hapjes u mbajt nga komandanti i b2k-së, nënkolonel Agim Kuçana, i cili ndër të tjera theksin e vuri tek eksperiencia e krijuar nga efektivët e b2k-së ndër vite, për sa i takon pjesëmarrjes në operacione paqeruajtëse. Është kjo eksperiencë, por edhe trajnimi i vijueshëm që kryhet në këtë repart që, sipas nënkolonel Kuçanës, e mbushin me besim se ky mision do të jetë i suksesshëm, ashtu si edhe misionet paraardhëse.

Duke marrë fjalën në ceremoni, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral Dimo ndër të tjera tha: "...Ceremoni të tilla mbartin në vetvete ndjenja dhe emocione të veçanta përgjegjësie dhe krenarie, sepse në saje të përfaqësimit tuaj dhe të shokëve tuaj në operacionet paqeruajtëse, ju keni krijuar tashmë një traditë me vlera të mëdha në këto misione, traditë kjo që sigurisht do të rritet dhe do të konsolidohet më tej nga misioni që ju do të kryeni në Kosovë. Gjithashtu ky është një moment që na bashkon të gjithëve për të transmetuar fjalë zemre, për të shprehur besimin në suksesin e misionit dhe për t'u dhënë bekimin gjithësecilit prej jush..."

Në mbyllje të fjalës së tij, gjeneral Dimo i siguroi familjarët e paqeruajtësve të Kontingjentit I shtesë me mision në Kosovë, se Forca Tokësore, por edhe Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria



Forca Tokësore nis kontingjentin e KFOR-3 në kuadër të misionit KFOR, Pejë, Kosovë



e Mbrojtjes do të jenë gjithmonë në kontakt me ta dhe pranë tyre, për çdo problem apo nevojë që do të kenë.

Të pranishmit, i përshëndeti në emër të kontingjentit, komandanti i kë-

tyre efektivëve, kapiten Dritan Çela, i cili pasi falënderoi eprorët për besimin e treguar i siguroi ata se misionin që iu është ngarkuar, do ta kryejnë me devotshmëri dhe profesionalizëm.

Kontingjenti I shtesë, përbëhet nga një togë e efektivëve të batalionit të Tretë të Këmbë-sorisë dhe do t'i bashkohet trupave të kontingjentit të Forcës Tokësore që ndodhen aktualisht

në Pejë, Kosovë, në kuadër të misionit KFOR. Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale.

Disa japin diçka për atdheun, të tjerë, si Dëshmori i Atdheut kapiten Feti Vogli, dhanë gjithçka

Në 11-vjetorin e rënies në krye të detyrës në Afganistan, vepra e tij ngelet burim frymëzimi për të gjithë brezat. Kapiten Feti Vogli ka lindur në fshatin Baldushk të rrethit të Tiranës. Pas mbarimit të Akademisë Ushtarake në specialitetin Artileri Tokësore, u bë pjesë e Forcave të Armatosura, me detyrë komandant Toge në Brigadën e Stërvitjes të Bazës, Bunavi. Pas kryerjes me sukses të kursit Bazë të Forcave Speciale, më 16 korrik 2005, u bë pjesë e Batalionit të Forcave Speciale me detyrë komandant Grupi. Nga data 1 qershor 2010 kryente detyrën e komandantit të Grupit të Parë Special në kompaninë e Aksioneve Speciale Ujore. Kapiten Feti Vogli ishte një ushtarak karriere i shkëlqyer dhe si rezultat i arritjeve në detyrë është dekoruar disa herë me medalje të ndryshme si: Medalja e Karrierës



në vitin 2007, nga komandanti i Forcës së Bashkuar. Medalja për Shërbime Ndërkombëtare nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2007. Medalje për shërbime të Shquara nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2010. Më 16 janar 2012, u nis me misionin luftarak "EAGLE 4" në përbërje të Batalionit të Forcave Speciale në Kandahar të Afganistanit, ku u vra në krye të detyrës gjatë shërbimit të tij

në një mision paqësor, në Kandahar të Afganistanit, në shkurt 2012. Në 11-vjetorin e rënies së kapiten Feti Voglit, u zhvillua një ceremoni përkujtimore edhe në mjediset e batalionit të Forcave Speciale në Zall - Herr, ku morën pjesë drejtues, shokë, miq dhe të afërmit të kapiten Voglit, të cilët vendosën kurora me lule pranë bustit të dëshmorit të atdheut.

Lavdi përjetë heroit!



Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia: Ju treguat dhe një herë se një vend i vogël mund të kryejë vepra të mëdha

Në mjediset e BMEC u zhvillua ceremonia e pritjes së përfaqësuesve të Komandës Mbështetëse në ndihmë të popullit turk, goditur nga tërmeti i 6 shkurtit. 15 efektivat e BMEC, 4 mjekë, efektivi të tjerë të FA-së së bashku me personel turk, kryen në qytetin e Malatias dhjetëra operacione kërkim-shpëtimi, duke shpëtuar dhe ndihmuar personat e prekur nga tërmeti.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishte i pranishëm komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i BMEC kolonel Hajdar Gurra, komandantë repartesh etj. Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneralmajor Xhebexhia në fjalën e tij, pasi falënderoi efektivat, u shpreh se: “Më veprën tuaj, ju treguat dhe njëherë se populli shqiptar është i pari në krah të çdo populli në vështirësi e veçanërisht të popullit turk, që na u gjend pranë në tërmetin që goditi vendin tonë, në nëntor 2019. Ju treguat dhe një herë se një vend i vogël mund të kryejë vepra të mëdha” Më pas, për efektivat pjesëmarrës në operacion u shpërndanë certifikata mirënjohjeje.



Studentët zhvilluan stërvitjen me dalje në “fushim dimëror”, në rajonin e Zall-Bastarit

Studentët e vitit të tretë, që ndjekin ciklin e parë të studimeve Bachelor në shkencë ushtarake, zhvilluan stërvitjen me dalje në “fushim dimëror”, në rajonin e Zall-Bastarit. Në këtë stërvitje morën pjesë 52 studentë, 3 komandues, 4 pedagogë, si dhe 7 personel mbështetës.

Qëllimi i stërvitjes ishte testimi i njohurive të marra nga studentët, testimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i aftësive drejtuese të tyre, në kushte ekstreme të motit.

Studentët zhvilluan marshimin me mjete në rrugëkalimin, nga dislokimi i përhershëm në drejtim të rajonit të stërvitjes. Vijuan angazhimin për ngritjen e fushimit dhe krijimin e kushteve për fjetje, ushqim dhe shërbim shëndetësor. Realizuan përnjohjen e rajonit të stërvitjes, zhvilluan topografi ushtarake, realizuan operacionet e kërkim-kontaktit, zbritje nga lartësitë (alpinizëm) dhe goditje objekti.

Studentët vijuan marshimin taktik në drejtim të Fekenit dhe kthim, ku u organizuan për të zhvilluar alpinizmin. Stërvitja vijoi me kalimin e pengesave ujore, alpinizëm, kryerje të luftimit në qendrat e banuara, pika kontrolli, si dhe operacione kërkim-kontakti.



Xhenierët e Komandës Mbështetëse përfundojnë punimet për ndërtimin e urës “bailey” në Xibër Murrizë, bashkia Klos



Pas kërkesës së komunitetit për ndërtimin e një ure të re mbi përroin e fshatit Xibër Murriz, specialistët xhenierë të Kompanisë së Urave në Batalionin e Xhenios, pas përfundimit të procedurave paraprake për njohjen e terrenit dhe përlllogaritjen e bazës materiale, filluan punimet.

Nga ndërtimi i kësaj ure nuk përfitojnë vetëm banorët e fshatit Xibër Murriz, por gjithë zona.

Kjo urë është me gjatësi 13 metra, me seksion 2/1 dhe me peshëmbajtje 40 ton dhe do të shërbejë për të lidhur midis tyre 7 lagje me rreth 850 banorë.



Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare të Italisë, anija e Rojës Bregdetare italiane “ITCG PB Alfredo Peluso” vizitoi Portin e Durrësit.

Gjatë qëndrimit në vendin tonë, komandanti i anijes italiane kapitenlejtënant Antonio Barbieri i shoqëruar nga atasheu ushtarak italian, kolonel Nicola Piccolo, zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare, ku u pritën nga komandanti i FD-së, kundëradmiral Adnand Agastra.

Kundëradmiral Agastra u uroi mirëseardhjen dhe i falënderoi për bashkëpunimin e deritanishëm dhe veçanërisht për ndihmën e dhënë nga pala italiane ndër vite.

Ekuipazhi i anijes italiane me efektivat e Grupit II Patrullues të Forcës Detare zhvilluan stërvitje të ndryshme që lidhen me veprimet e efektivit në luftën kundër zjarrit, ujit apo avarive të ndryshme në anije. Këto stërvitje ndikuan pozitivisht në trajnimin e efektiveve si dhe ndërveprimin ndërmjet forcave, duke përmirësuar pritshmëritë në realizimin e detyrave dhe objekti-

Anija e Rojës Bregdetare italiane “ITCG PB Alfredo Peluso”, vizitë në portin e Durrësit



vave në zbatimin e ligjshmërisë dhe sigurisë lundimore.

Po kështu anija italiane u vizitua nga nxënësit e Shkollës së Mesme të

Navigationit të qytetit Durrës, të cilët bënë një vizitë në anije dhe u njohën nga afër me detyrat që kryejnë efektivat e Rojës Bregdetare në Itali.



75 vjet CISM: "Miqësi nëpërmjet sportit - Friendship through sport"

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Sporteve Ushtarake (CISM), në të gjitha komandat e Forcave Mbështetëse dhe strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të RSH, u zhvilluan aktivitete të shumëllojshme sportive në nder të festimeve të "International Day of Military Sports 2023", nën moton "Miqësi nëpërmjet sportit".

FARSH, në Komandat e Forcave/Mbështetëse dhe strukturat e tjera në vend dislokimit e tyre në këtë përvjetor ndërkombëtar sportiv, kanë marrë pjesë me rreth 3000 efektivë, të cilët u aktivizuan me një shumëllojshmëri disiplinash sportive.

Në çdo mjedis sportiv të FARSH, data 17 shkurt u kthye në një festë të vërtetë sportive, ku u zhvilluan aktivitete sportive të ndryshme si vrapime shpejtësie dhe rezistence, lojë futbollit, minifutbollit 5*5, futbollit i sallës, volejbollit, basketbollit, ping-pong, shah, ushtrime aerobike etj.

CISM (International Military Sport Council), është Këshilli Ndërkombëtar i Sporteve Ushtarake, themeluar më 18 shkurt 1948, ku aderojnë Forcat e Armatosura të 140 vendeve nga e gjithë bota, midis tyre edhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Dita e vrapimit dhe aktivitete të tjera sportive të CISM-së zhvillohen çdo vit nga vendet anëtarë të kësaj organizate, duke u kthyer në ditën ku ushtarakë dhe civilë vrapojnë së bashku në gjithë botën nën flamurin e sportit dhe paqes. Ky aktivitet ka si qëllim promovimin e aktiviteteve sportive dhe edukimit fizik ndërmjet Forcave të Armatosura për të krijuar ura lidhëse miqësie dhe duke ushqyer paqen me njëri-tjetrin dhe duke dhënë mesazhin për Paqe nëpër botë. Motoja e CISM-it është "Miqësi nëpërmjet Sportit - Friendship through sport".

Krijimi i CISM-së si një projekt global

Pesë kombe themeluese, Belgjika, Danimarka, Franca, Luksemburgu dhe Holanda, krijuan CISM-në ndërsa u takuan në Nisë, më 18 shkurt 1948. Megjithatë ishin vetëm vende Evropiane, kombet themeluese të CISM-së kishin në mendje një projekt global.

Kjo dëshirë e ushtrisë për t'u takuar në arena sportive në vend të shesheve të betejës nuk ishte asgjë e re në vitin 1948. Në të vërtetë, pikërisht pas Luftës së Parë Botërore, Lojërat e Para Verore Botërore Ushtarake CISM u organizuan me iniciativën e gjeneralit Pershing dhe rrethimit të tij, me 18 kombe që përfaqësonin pesë kontinente. Në vitin 1919, 1500 atletë garuan në 24 sporte të ndryshme përpara një publiku të madh në Joinville, në periferi të Parisit.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Këshilli Sportiv i Forcave Aleate u ringjall. Lojërat e dyta ndërlidhëse u mbajtën në Berlin në vitin 1946. U organizuan vetëm gara atletike. Dëshira për t'u takuar mes ushtarëve ishte më e fortë se nevoja për të prodhuar me çdo kusht arritje sportive goditëse. Në maj 1946, u krijua Këshilli Sportiv i Forcave Aleate, përkatësisht nga koloneli Debrus dhe majori Mollet, të cilët ishin ndër baballarët themelues të CISM-së dy vjet më vonë. Fatkeqësisht, për



shkak të mosmarrëveshjeve politike, Këshilli Sportiv i Forcave Aleate u shua në vitin 1947. Megjithatë, ideali u rilind vitin e ardhshëm me themelimin e CISM-së dhe ngritjen e një vizioni global.

Që nga themelimi i tij në vitin 1948, universaliteti i CISM-së u bë gjithnjë e më i vërtetë, i zhvilluar siç ishte nga Presidentët dhe Sekretarët e Përgjithshëm që drejtuan organizatën gjatë viteve. Në vitin 1950, Argjentina dhe Egjipti iu bashkuan, deri atëherë, nëntë vende evropiane. Në vitin 1951, ishte radha e SHBA-së për t'u bashkuar. Në vitin 1952, Iraku, Libani, Pakistani dhe Siria u bënë anëtarë dhe në 1954 Brazili. Me kalimin e viteve, anëtarësimi ka përparuar me një ritëm të qëndrueshëm. Shfaqja e Luftës së Ftohtë dhe krijimi i SKDA, një organizatë sportive ushtarake, vendet anëtare të së cilës ishin gjithashtu anëtarë të Traktatit të Varshavës, të cilit CISM-ja i mohoi statusin zyrtar universal që donte dhe duhej të njihet nga IOC. Por kthesa politike në fund të viteve '80, dhe më konkretisht rënia e murit të Berlinit krejt papritur, i dha një shtysë të përtërirë zgjerimit të CISM-së. Në hapësirën e vetëm katër viteve (1991-1995), 31 vende të reja anëtare iu bashkuan organizatës.

Një përparim i tillë i shpejtë çoi në njohjen nga institucionet ndërkombëtare si IOC.

Një tjetër ngjarje e rëndësishme në historinë e CISM-së ndodhi në shtator 1995, me organizimin e Lojërave të Para Verore Botërore Ushtarake CISM në Romë. CISM është bërë, me 133 vendet e saj anëtare, kalendarin vjetor të sporteve botërore, kontinentale dhe rajonale, nivelin e lartë të konkurrencës së tij (Këshilli Ndërkombëtar i Sporteve Ushtarake nuk mund të mbajë më gjurmët e kampionëve të panumërt të botës dhe kontinentit, të cilët janë gjithashtu të njohur për shfrytëzime brenda konkurrencës civile), një nga institucionet më të mëdha sportive në botë.

Që nga viti 1995, CISM ka organizuar çdo katër vjet Lojërat Verore Botërore Ushtarake CISM, një ngjarje shumë-sportesh e mbajtur një vit

përpara vitit të organizimit të Lojërave Olimpikë. Lojërat e Para Verore Ushtarake Botërore CISM 1995 u mbajtën në Romë nga 4 deri më 16 shtator 1995. 93 kombe garuan në 17 ngjarje të ndryshme sportive për të festuar 50-vjetorin e Luftës së Dytë Botërore dhe të ratifikimit të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në 1999, Lojërat e Dytë Verore Botërore Ushtarake, CISM 1999, u mbajtën në gusht 1999 në Zagreb, Kroaci, 7000 pjesëmarrës nga 82 kombe garuan në 20 sporte. Në vitin 2003, Lojërat e 3-ta Verore Botërore Ushtarake CISM 2003 u mbajtën në dhjetor 2003 në Catania, Itali, pjesëmarrës nga 84 kombe të ndryshme garuan në 13 sporte. Në vitin 2007, Lojërat e 4-ta Verore Botërore Ushtarake CISM 2007 u mbajtën në tetor 2007 në Hyderabad, Indi, me pjesëmarrës nga 101 vende, të cilët garuan në 14 sporte. Në vitin 2011, Lojërat e 5-ta Verore Botërore Ushtarake CISM 2011 u mbajtën në korrik 2011 në Rio de Janeiro, Brazil, pjesëmarrës nga 108 vende garuan në 20 sporte. Brazili kryesoi tabelën e medaljeve me 45 medalje ari, 33 argjendi dhe 36 bronzi. Kina ishte e dyta me 37 medalje ari, 28 argjendi dhe 34 bronzi. Italia fitoi 14 medalje ari, 13 argjendi dhe 24 bronzi, për të përfunduar treshen e parë. Lojërat olimpikë të 6-ta në Kore dhe Lojërat e shtata Olimpikë në Wuhan, Kinë.

Misioni, vizioni, motoja, vlerat dhe objektivat strategjike të CISM-së

Karta e Gjellbër e CISM-së, është ajo që përfshin misionin, vizionin, moton, vlerat dhe objektivat strategjike të CISM-së.

Misioni i CISM-së thekson se "Duke miratuar Miqësinë midis Ushtarakëve, CISM është sporti ushtarak ndërkombëtar në mbarë botën, Organizatë e përkushtuar për të bashkuar personelin e Forcave të Armatosura nga të gjitha Kombet përmes aktiviteteve sportive, duke mundësuar kështu përgatitjen fizike, gatishmërinë ushtarake dhe edukimin e Forcave të Armatosura". Kurse vizioni i CISM-së thekson se "CISM është organizata lider botërore sportive ushtarake që rrit respektin reciprok, solidaritetin dhe promovimin e paqes nëpërmjet aktiviteteve sportive". Nga ana tjetër Motoja e CISM-së është "Miqësia nëpërmjet sportit", "Sport dhe Paqe", "Shëndet dhe sport ushtarak". Vlerat e CISM-së shënohen nga "Solidariteti, Miqësia, Respekti, Barazia, Integriteti dhe Vendorsmëria."

Objektivat kryesore strategjike janë si Mbështetje për Strategjinë e anëtarësimit në CISM; Nën-objektivat që mbështesin: Politika e Zgjerimit të CISM-së; Përmirësimi i marrëdhënieve në nivel politik për të mirëpritur Kombet e reja Anëtare; Identifikimi

i marrëdhënieve Pasuritë; Politika e riaktivizimit të CISM-së; Përmirësimi i marrëdhënieve në nivel politik për të riaktivizuar vendet anëtare të larguara; Rritja e motivimit të vendeve anëtare për të qenë më të përkushtuar (pjesëmarrje/organizimi); Rritja e shikueshmërisë së brendshme dhe të jashtme të CISM-së si Sporti Ushtarak Ndërkombëtar në mbarë botën.

Përse MM dhe FA-të në mbarë Botën duhet të mbështesin CISM-në?

Arsyeja që na çon drejt pyetjes se përse MM dhe FA-të në mbarë Botën duhet të mbështesin CISM-në në forcat e Armatosura, është sepse nxit besimin dhe kohezionin mes ushtarakëve, krijon ushtarakë të përshtatshëm dhe të motivuar, rrit atraktivitetin e shërbimit ushtarak, identifikon, trajnon dhe motivon talentet në FA, si dhe ofron përvojë nga konkurrenca ndërkombëtare të pjesëmarrjeve në CISM. Gjithashtu sporti në shoqëritë ushtarake ndikon në rritjen e kompetencës ndërkulturore dhe ndërkombëtare. E përdor Sportin si mundësues efektiv diplomatik, rrit solidaritetin midis shteteve pjesëmarrëse, përdor sportin për de-konfliktacion dhe ndërton paqe midis vendeve pjesëmarrëse, por edhe mbështet përhapjen në mbarë botën të të drejtave të njeriut.

Me rëndësi është dhe organizimi i cili ka dhe nën-objektivat që mbështesin atë. Objektivat janë rritjet e jashtme, rritja e marrëdhënieve në nivel politik, rritja e marrëdhënieve në nivel institucional, rritja e marrëdhënieve në nivel sportiv. Por gjithashtu përmendim edhe rritjet e brendshme; përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet organeve të CISM-së dhe vendeve anëtare; përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet vendeve anëtare; konsolidimi i marrëdhënieve me autoritetet kombëtare; Strategjia Komunikimit. Gjithashtu, përmirësimi i politikës së komunikimit CISM është një objektivi tjetër, si dhe zbatimi i një strategjie moderne dhe integruese të sportit CISM, gjithashtu. Kurse nën-objektivat që e mbështesin janë: Modernizimi i Modelit Sportiv CISM për të qenë më tërheqës, i përshtatshëm, gjithëpërfshirës, i larmishëm dhe universal; Pjesëmarrja dhe organizimi i ngjarjeve të vendeve anëtare; Krijimi dhe ekzekutimi i një strategjie për të inkurajuar pjesëmarrjen e vendeve anëtare në CISM, Kam-



pionatet; Motivimi i vendeve anëtare për të organizuar ngjarjet CISM në të gjitha nivelet; Zhvillimi i kapaciteteve të kombeve për të pritur ngjarje Paraspport; Inkurajon dhe nxit partneritetet e jashtme në eventet CISM; Politika anti doping; Sigurimi i një mjedisi të pastër për ushtrimin e sporteve në CISM etj.

Rritja e aftësive të CISM-së në fushat akademike dhe shkencore është një përfitim nga pjesëmarrja në të, që gjithashtu ka një sërë nën-objektivash që e mbështesin siç është: Krijon një rrjet ushtarak dhe civil të Shkencave Sportive, për një bashkëpunim global, nën ombrellën e Akademisë CISM; Ngre Akademinë CISM në standardet e përsosmërisë, duke e kthyer atë në një "Think Tank"; Zhvillon "CISM Sports Science, Education & Research, Publishing and Memory"; Ofron në mënyrë aktive Programet e Solidaritetit CISM. Gjithashtu të tjera nën-objektiva që mbështesin janë mblidhja në mënyrë sistematike e informacioneve që identifikojnë nevojat dhe ofertat për solidaritet; lidh nevojat e kombeve dhe ofertat e kombeve; si dhe identifikon burimet që mbështesin nevojat e vendeve anëtare.

Gjithashtu, arsye pse duhet të mbështesim CISM-në është sepse kjo mbështetje "Ofron në mënyrë aktive Programet e Sportit dhe Paqes CISM", ku nën-objektivat që mbështesin janë: Mbledh në mënyrë sistematike informacione që identifikojnë mundësitë për Programet e Sportit dhe Paqes; Identifikon burimet që mbështesin Veprimet e Sportit dhe Paqes CISM; Promovon, zhvillon dhe komunikon në mënyrë efektive për veprimet e përpikta të Sportit dhe Paqes. Gjithashtu përmendim edhe "Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të CISM", ku nën-objektivat që mbështesin janë: stabiliteti financiar; rritja e të ardhurave financiare dhe burimeve të CISM-së si për funksionimin ashtu edhe për zhvillimin e buxheteve; eksploron burime të reja financiare dhe të ardhurash; qeverisje të mirë dhe praktikata më të mira; Kryen një auditim të strukturave të CISM-së dhe përshtatja nëse është e nevojshme; si dhe rishikon, thjeshton dhe optimizon rregulloret dhe funksionimin e brendshëm të CISM-së.

CISM sot, sporti dhe solidariteti

I themeluar më 18 shkurt 1948 në Nice (Francë), Këshilli Ndërkombëtar i Sporteve Ushtarake (CISM) është një nga organizatat më të mëdha multidisciplinare në botë.

CISM organizon ngjarje të ndryshme sportive për Forcat e Armatosura të 140 vendeve anëtare dhe është një nga organizatat sportive globale në të cilën përfaqësohet numri më i madh i disiplinave sportive. Ushtarët, të cilët mund të ishin takuar më parë në fushën e betejës, tani takohen miqësisht në fushën e lojës sportive. Kjo është në përputhje me filozofinë dhe idealin e përcaktuara në deklaratën e misionit të CISM-së në 1998, të nënshkruar nga të gjitha vendet anëtare. Aktivitetet e shumta në mbarë botën, kontinentale dhe rajonale zhvillohen gjatë gjithë ditëve të vitit. Dy shtyllat e CISM-së që funksionojnë si bazë për këto ngjarje janë sporti dhe solidariteti.

CISM është bërë një palë e interesuar që nuk mund të injorohet më nga komuniteti ndërkombëtar sportiv. Ai luan një rol të rëndësishëm në stërvitjen e atletëve të elitës. Një pionier i vërtetë në solidaritetin ndërkombëtar sportiv, CISM ka zbatuar projekte të organizuara në bashkëpunim me IOC (Komiteti Olimpik Ndërkombëtar) dhe organizata të tilla si Kombet e Bashkuara dhe Komuniteti Evropian.



Ne kemi zhvilluar një marrëdhënie të ngushtë pune me federatat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe me të gjitha autoritetet ndërkombëtare sportive.

CISM organizon çdo vit mbi njëzet

të ndryshme sportive për të festuar 50-vjetorin e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Edicioni i parë i Lojërave Dimërore Botërore Ushtarake CISM u mbajt në vitin 2010 në Itali,



kampionate botërore ushtarake për sporte të ndryshme, në të cilët mund të marrin pjesë të gjitha vendet anëtare, gjithashtu organizon gara kontinentale dhe rajonale si edhe çdo katër vjet mbahen Lojërat Verore Botërore Ushtarake CISM dhe së fundmi Lojërat Dimërore Ushtarake Botërore CISM. Këto janë ngjarje shumë-sportesh të organizuara nga CISM në lidhje me vendet anëtare të CISM.

Lojërat e Para Verore Ushtarake Botërore CISM u mbajtën në 1995 në Romë. 93 kombe garuan në 17 ngjarje



në Rajonin e Luginës së Aostës, ku 43 vende të ndryshme dhe më shumë se 800 atletë kanë garuar në nivelin më të lartë në sportet dimërore.

Kampionët, Luiza Gega një prej tyre

Sportet Ushtarake Ndërkombëtare janë aq të shumta sa nuk mund të mbajnë më gjurmët e kampionëve të panumërt ushtarakë, të cilët janë gjithashtu të njohur për bëmat e tyre në garat civile. Paul Tergat, Aleksey Nemov, Valentina Vezzali, Mark Huizinga, Pavel Kolobkov, Renata Mauer, Pyrrros Dimas Albania (Greqi) dhe Fabrizio Mori, janë vetëm disa nga atletët ushtarakë që kryesojnë rregullisht ngjarjet sportive ndërkombëtare. Kurse nga Kampionët shqiptarë është Luiza Gega, vendi i tretë në Lojërat Olimpikë verore Wuhan 2019. FARSH, sot kontribuojnë me sportistë elitare të shumtë.

Të rëndësishme janë edhe simpoziumet. CISM përpiket të organizojë simpoziume ndërkombëtare pothuajse çdo vit, për të studiuar aspekte të ndryshme të edukimit fizik dhe sportit brenda Forcave të Armatosura. Simpoziumi i fundit me temën "Shkenca sportive: mjet themelor i menaxhimit modern të sportit" u zhvillua në Pragë, Republika Çeke, nga data 18 deri më 23 shtator 2009. Me këtë rast kanë qenë 70 pjesëmarrës nga 27 vende. Një nga momentet më të rëndësishme ishte rihapja e CISM Academy. Libri i punimeve të këtij Simpoziumi do të shtypej në prill 2010 dhe do t'i shpërndahej të gjithë familjes CISM.

Sport dhe paqe

Në vitin 2005, CISM organizoi seminarin "Sporti dhe paqja" i cili u mbajt në Mantova të Italisë. Përfaqësues nga më shumë se 22 vende, organizata ndërkombëtare, IOC, OKB, UNICEF, Shoqatat Sportive, Kombet Anëtare të CISM-së dhe organizatat që merren drejtpërdrejt me paqen, shëndetin, sportin dhe arsimin morën pjesë në seminar. Të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord se sporti ishte bërë një mjet i rëndësishëm për të ndihmuar rindërtimin e shoqërive në situata pas konfliktit. Në tetor 2007, gjatë Lojërave të 4-ta Verore Botërore Ushtarake CISM në Indi,



CISM organizoi në partneritet me IOC, Shoqatën Olimpikë Indiane dhe Komitetin Organizativ të Lojërave Botërore, një Forum Ndërkombëtar mbi "Sportin për Paqe", me temë: "Sporti, një mjet themelor konkret për të promovuar paqen". Nëpërmjet leksioneve të tyre, autoritetet të ndryshme prezantuan përvojat dhe pritshmëritë e tyre në lidhje me përdorimin e sportit si një mjet për të edukuar dhe ndihmuar procesin e rindërtimit në situatat pas konfliktit.

Këtë vit, më 20 mars, në kuadër të

Lojërave Dimërore, CISM organizoi në bashkëpunim të ngushtë me IOC, Forumin Ndërkombëtar me temë "Sporti për Paqe - Nga iniciativat pozitive të programet e integruara sistematike".

Kjo ngjarje e jashtëzakonshme, së bashku me iniciativat tona të mëparshme (Mantova 2005 dhe Hyderabad 2007), kanë treguar me sukses se sporti (dhe veçanërisht sporti ushtarak) është një mjet themelor i aftë për të promovuar paqen dhe mund të jetë i dobishëm për misionet paqeruajtëse në mbarë botën. Të gjithë pjesëmarrësit dhe institucionet pranuan se CISM dhe Forcat e Armatosura janë lojtarë të rëndësishëm në lëvizjen "Sport për Paqe" dhe ranë dakord që partneritetet janë mësimi më i rëndësishëm i nxjerrë që mund të nxisë konkretisht përdorimin e sportit si një mjet zhvillimi në zonat e konfliktit.

Forumi mbështetej në autoritete emnente si HSH Princi Albert II i Monakos dhe të ftuar të tjerë të shquar si lektorë nga IOC, Kombet e Bashkuara, NATO, Vatikani, Organizata e Sportit dhe Paqes, ish-komandantët në Operacionet Paqeruajtëse dhe autoritetet e CISM-së dhe tregoi se Këshilli ynë është në gjendje të ndërtojë ura ndërmjet institucioneve ndërkombëtare dhe të krijojë sinergji. Të gjithë pjesëmarrësit e Forumit kanë nënshkruar një deklaratë të titulluar "CISM Aosta Call-to-Action 2010 on Sport for Peace", duke përmbledhur dëshirat e përbashkëta dhe duke u kërkuar të gjitha institucioneve të krijojnë zyrtarisht një marrëveshje dypalëshe dhe të ndërsjellë në mënyrë që të ndërmarrin programe konkrete që synojnë ndarjen e së mirës, praktikata dhe zbatimin efektiv të programeve Sport për Paqe.

Ndërkohë përmendim Zyrën e CISM-

së. Sekretariati i Përgjithshëm i CISM-së ndodhet në një rezidencë të madhe në qendër të Brukselit. I vendosur pranë zonave të famshme si Place Flagey, Châtelain, Schuman (Selia e BE-së), Sekretariati i Përgjithshëm CISM është vetëm 30 minuta larg nga Aeroporti Kombëtar i Brukselit, me president Kryetar i Përgjithshëm i CISM, Acting President, kolonel Dirk Schwede dhe Sekretar i Përgjithshëm, Secretary General Navy Captain Roberto Recchia.

Major Gernat Qirici

Armatimi dhe mbështetja, ministri i Jashtëm i Ukrainës dhe Përfaqësuesi i Lartë i BE-së, pritje në selinë e NATO-s

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg priti ministrin e Jashtëm të Ukrainës Dmytro Kuleba dhe Përfaqësuesin e Lartë të BE-së Josep Borrell në selinë e NATO-s, më 21 shkurt 2023. “Ndërsa një vit më parë, Presidenti Putin filloi luftën e tij të paligjshme kundër një fqinji paqësor, Ukrainës, tashmë faktet janë të qarta për të gjithë dhe ajo që duket është se askush nuk po sulmon Rusinë, sepse nga ajo që po ndodh çdo ditë në terren shihet që Rusia është agresori dhe nga ana tjetër Ukraina është viktimë e agresionit”. NATO po mbështet të drejtën e Ukrainës për vetëmbrojtje, e cila është e sanksionuar në Kartën e OKB-së.

Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg tha se “presidenti Putin mendoi se mund të shkatërronte Ukrainën dhe të përçante NATO-n, por ai nënvlerësoi vendosmërinë e popullit ukrainas për të mbrojtur atdheun e tij, dhe ai, Putini, nënvlerësoi unitetin tonë”.

Ndërsa përsëriti mbështetjen e palëkundur të NATO-s për Ukrainën, Sekretari i Përgjithshëm tha se mbështetja e NATO-s duhet të shtohet për të. “Ne duhet t’i japim Ukrainës atë që i nevojitet për të fituar dhe për të mbizotëruar si një komb sovran i pavarur në Evropë”. Ai tha se NATO ra dakord të ndihmojë Ukrainën të zhvillojë një sistem prokurimi efektiv, transparent dhe të përgjegjshëm. Stoltenberg tha se u ra dakord gjithashtu që të thërritet “një takim i ekspertëve të prokurimit të NATO-s, BE-së dhe Ukrainës për të parë se çfarë mund të bëjmë më shumë së bashku për të siguruar që Ukraina të ketë armët që i nevojiten”. Kurse në lidhje me vendimin e Ruisë për të pezulluar pjesëmarrjen e saj në Traktatin New START, Sekretari i Përgjithshëm tha se me këtë e gjithë arkitektura e kontrollit të armëve është çmontuar. “E inkurajoj fuqishëm Rusinë që të rishqyrtojë vendimin e saj dhe të respektojë marrëveshjet ekzistuese”, - tha ai.

Rusia po mobilizon trupa për ofensiva të reja

Pritja e ministrit ukrainas Dmytro Kuleba së bashku me Përfaqësuesin e Lartë të BE-së Josep Borrell, në selinë e NATO-s, ishte simbol i solidaritetit të NATO-s dhe BE-së për Ukrainën. “Një vit më parë, Presidenti Putin filloi luftën e tij të paligjshme kundër fqinjit paqësor. Faktet janë të qarta për të gjithë. Askush nuk po sulmon Rusinë. Rusia është agresori. Ukraina është viktimë e agresionit dhe ne po mbështesim të drejtën e Ukrainës për vetëmbrojtje, një e drejtë e cila është e përfshirë në Kartën e OKB-së”, - tha në konferencën për shtyp Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, që mbajti së bashku me ministrin e Punëve të Jashtme të Ukrainës, Dmytro Kuleba dhe Përfaqësuesin e Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Josep Borrell. “Është Presidenti Putin që filloi këtë luftë perandorake pushtuese. Është Putin ai që vazhdon të përshkallëzojë luftën. Ai mendoi se mund të shkatërronte Ukrainën dhe të na ndante. Por ai nënvlerësoi vendosmërinë e popullit ukrainas për të mbrojtur atdheun e tyre, ai e nënvlerësoi unitetin tonë”, - tha shefi i NATO-s. “Por tashmë, ndërsa po bëhet një vit që kur filloi pushtimin rus, ne nuk shohim asnjë shenjë se presidenti Putin po përgatitet për paqe. Përkundrazi, siç e bëri të qartë sot ai, po përgatitet për më shumë luftë. Rusia po fillon ofensiva të reja dhe ajo po mobilizon më shumë trupa, duke arritur Korenë e Veriut dhe Iranin”. Teksa tha se Putini nuk duhet të fitojë,

Stoltenberg: Rusia të rishqyrtojë vendimin e saj për New START dhe të respektojë marrëveshjet ekzistuese



Stoltenberg theksoi edhe njëherë se kjo do të tregonte se agresioni funksionon dhe forca shpërblehet. “Do të ishte e rrezikshme për sigurinë tonë dhe për të gjithë botën. Ne jemi gjithashtu gjithnjë e më të shqetësuar se Kina mund të planifikojë të ofrojë mbështetje vdekjeprurëse për luftën e Ruisë. Prandaj NATO-s i duhet të mbështesë dhe të shtojë mbështetjen e saj për Ukrainën. Ne duhet t’i japim Ukrainës atë që i nevojitet për të fituar, që ajo të mbizotërojë si një komb sovran i pavarur në Evropë. Njoftimet e fundit nga aleatët për tanke të reja, armatime të rënda dhe trajnime për trupat ukrainase, i mirëpres”, - tha shefi i NATO-s. “Është urgjente të përmbushen të gjitha këto premtime. Tashmë kjo është shndërruar në një luftë rrëqethëse rrënim, është një betejë logjistike dhe aftësitë kryesore duhet të arrijnë në Ukrainë përpara se Rusia të mund të kapë vullrin”. Stoltenberg tha se së bashku me ministrin e Jashtëm Kuleba dhe Përfaqësuesin e Lartë Borrell kishin diskutuar nevojën për të rritur prodhimin dhe përmirësimin e sistemeve të prokurimit për të vazhduar mbështetjen për Ukrainën. “Me kërkesë të Ukrainës, ne kemi rënë dakord që NATO duhet të ndihmojë Ukrainën për të zhvilluar një sistem prokurimi që është efektiv, transparent dhe i përgjegjshëm”, - tha ai. “Ne gjithashtu ramë dakord sot të thërrasim një takim të ekspertëve të prokurimit të NATO-s, BE-së dhe Ukrainës për të parë se çfarë mund të bëjmë më shumë së bashku për të siguruar që Ukraina të ketë armët që i nevojiten. Në NATO, ne kemi punuar për rritjen e prodhimit për shumë muaj. NATO vendos standardet për municionet dhe pajisjet për të gjithë aleatët. Ne kemi përfunduar një studim të jashtëzakonshëm të rezervave të municioneve, u takuam me industrinë e mbrojtjes vjeshtën e kaluar dhe vazhdojmë të angazhohemi me ta. Ne do të rrisim objektivat tona për rezervat e municioneve përmes Procesit të Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s. Kjo do të ndihmojë gjithashtu për t’i dhënë industrisë së mbrojtjes kërkesën dhe kontratat afatgjata që u nevojiten për të investuar dhe prodhuar më shumë”.

NATO ka pasur prokurime të për-bashkëta midis aleatëve për shumë vite. Duke përgëzuar BE-në për përpjekjet e saj për të nxitur një prodhim më të madh, Stoltenberg tha se NATO, ka qenë e përgatitur dhe ka punuar me BE-në për këtë edhe më parë. “Ne kemi parë një model të agresionit rus gjatë shumë

viteve. Gjeorgjia në 2008, Krimea dhe Donbas 2014 dhe pushtimin e plotë vitin e kaluar. Duhet të bëhet e qartë se e ardhmja e Ukrainës është brenda familjes euroatlantike dhe se kur të përfundojë lufta, ne duhet të vendosim marrëveshje afatgjata për sigurinë e Ukrainës. Për të garantuar që Rusia të mos vazhdojë të heqë dorë nga siguria evropiane dhe për të thyer ciklin e agresionit rus. Ndërkohë NATO do të vazhdojë të qëndrojë me Ukrainën, për aq kohë sa duhet dhe do të vazhdojë të punojë ngushtë për këtë me BE-në”. Në mbyllje të konferencës për shtyp, shefi i NATO-s shprehu keqardhje për vendimin e Ruisë për të pezulluar pjesëmarrjen e saj në Traktatin New START”. Gjatë viteve të fundit Rusia ka shkelur dhe është larguar nga marrëveshjet kryesore të kontrollit të armëve. “Me vendimin e sotëm për New START, e gjithë arkitektura e kontrollit të armëve është çmontuar. Unë inkurajoj fuqishëm Rusinë që të rishqyrtojë vendimin e saj dhe të respektojë marrëveshjet ekzistuese”, - tha ai.

NATO ka detyrë të parandalojë që lufta të përshkallëzohet përtej Ukrainës

“Ajo që keni parë sot është se Presidenti Putin në asnjë mënyrë nuk po përgatitet për paqe”, - iu tha Sekretari i Përgjithshëm gazetarëve, në vlerësimin e tij për kërcënimin e Putinit në fjalimin e fundit të 21 shkurtit. “Ai po përgatitet për më shumë luftë. Ai po përgatitet për ofensiva të reja, po mobilizon më shumë trupa dhe po dërgon më shumë armë dhe pikërisht kjo është arsyeja pse ne duhet të shtojmë mbështetjen tonë për Ukrainën, sepse do të jetë një tragjedi për ukrainasit, por edhe e rrezikshme për të gjithë ne, nëse Presidenti Putin fiton në Ukrainë. Duhet të kujtojmë se kjo është një luftë e zgjedhur. Kjo është një luftë agresioni. Rusia vendosi të pushtojë një fqinj, Ukrainën. Dhe Ukraina natyrisht ka të drejtë të mbrohet”, - tha Stoltenberg për mediat. “Kjo është e sanksionuar në Kartën e OKB-së dhe ne, aleatët e NATO-s, anëtarët e BE-së, të gjithë ne, kemi të drejtë të ofrojmë mbështetje për Ukrainën. Dhe kjo është pikërisht ajo që ne po bëjmë”, - ritheksoi ai. “NATO po i ofron mbështetje Ukrainës, po rrit dhe dorëzon armë më të rënda, më të avancuara, duke e bërë këtë në konsultime të vazhdueshme me Ukrainën për lloje të ndryshme armësh, por gjithashtu të sigurohet që të gjitha sistemet dhe armët

të funksionojnë siç duhet. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me sigurimin e sistemeve të reja, por edhe me sigurimin që artilleria, forca të blinduara, sistemet e mbrojtjes ajrore, të cilat janë dorëzuar tashmë, të kenë pjesët rezervë, të kenë municionin, të kenë mirëmbajtjen, të kenë lëndë djegëse që ata kanë nevojë për të funksionuar, dhe për këtë arsye kjo është me të vërtetë një betejë logjistike. E rëndësishme është mënyra se si të ofrohen të gjitha furnizimet dhe e gjithë mbështetja që Ukraina ka nevojë për të mbrojtur veten. Në të njëjtën kohë NATO ka edhe një detyrë tjetër, të parandalojë përshkallëzimin e kësaj lufte përtej Ukrainës”, arsyeja pse NATO që në mëngjesin e parë të pushtimit, aktivizoi planet e mbrojtjes dhe shtoi mijëra trupa të tjera në praninë e saj në pjesën lindore të Aleancës, mbështetur nga fuqi të konsiderueshme ajrore dhe detare për t’i dërguar një mesazh shumë të qartë Moskës se, NATO është atje për të mbrojtur çdo centimetër të territorit të NATO-s.” Sipas nenit 5 nëse një aleat sulmohet, ai do të konsiderohet si një sulm ndaj të gjithë Aleancës. “NATO do të vazhdojë të mbështesë Ukrainën për aq kohë sa të duhet dhe do të vazhdojë të ofrojë një parandalim dhe mbrojtje të besueshme për të gjithë territorin e NATO-s”.

Kontrolli i armëve, Rusia pezullon pjesëmarrjen në traktatin New START

Më shumë armë bërthamore dhe më pak kontroll të armëve e bëjnë botën më të rrezikshme. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, i kërkoi Ruisë që ta rishqyrtojë vendimin e saj për pezullimin e pjesëmarrjes në traktatin me Shtetet e Bashkuara që kufizon arsenalin strategjik bërthamor të të dyja palëve. Këtë Stoltenberg e bëri edhe në deklaratën e tij edhe në përgjigjen që iu dha gazetarëve kur u pyet. “Kjo është arsyeja pse në NATO ne kemi punuar kaq shumë për të angazhuar Rusinë në çështjet që lidhen me kontrollin e armëve dhe pse aleatët e NATO-s kanë mbështetur New START, dhe gjithashtu pse unë po i bëj thirrje Ruisë sot që të rishqyrtojë vendimin e saj për të pezulluar pjesëmarrjen e saj në marrëveshjen New START”. Ai kujtoi se kjo është një nga marrëveshjet e fundit të mëdha të kontrollit të armëve, pasi Rusia filloi të shkelte marrëveshjen që ndalonte armët e vjetra me rreze të mesme. Traktatin INF dhe që çoi në rënien e tij disa vite më parë. Tani është Rusia sërish që në fakt po pezullon traktatin tjetër të madh të kontrollit të armëve bërthamore, New START, i cili rregullon dhe vendos kufizime në numrin e përgjithshëm të armëve strategjike me rreze të gjatë. “Pra, ky është vetëm një shembull tjetër që ne po largohemi nga arkitektura e kontrollit të armëve, rregulli ndërkombëtar i bazuar në rregulla që kemi përdorur me dekada për ta ndërtuar atë hap pas hapi dhe me një marrëveshje. Pra, kombinimi i Ruisë që shkel disa prej këtyre marrëveshjeve, duke çuar në rënien e Traktatit INF, dhe më pas largimin nga New START, e bën botën më të rrezikshme dhe thjesht thekson rëndësinë që ne të qëndrojmë së bashku, të gjitha vendet që besojnë në rregulla të bazuara në rendin ndërkombëtar, dhe që besojnë në liri dhe demokraci”, - tha Stoltenberg

për mediat.

Në fjalimin e 21 shkurtit drejtuar kombit të tij, presidenti rus Putin, tha se është i detyruar të njoftojë se Rusia është duke e pezulluar pjesëmarrjen në traktatin për armët strategjike. Ai tha se Rusia nuk po tërhiqet nga marrëveshja por vetëm po pezullon pjesëmarrjen. Kujtojmë se i ashtuquajtur i START-i i Ri, është traktati i vetëm për armët bërthamore SHBA-Rusi, i cili zgjati deri në vitin 2021. I nënshkruar fillimisht në vitin 2010, ky traktat u kufizon palëve posedimin e kokave bërthamore me rreze të gjatë në 1.550, shifër më e vogël sesa ajo që ka qenë në marrëveshjen fillestare.

NATO do të ndihmojë Ukrainën të zhvillojë një sistem prokurimi efektiv

E ndërsa tha se Rusia po përgatitet për përshkallëzim të luftës, e jo për paqe, Stoltenberg njoftoi se NATO po planifikon që të mbajë një takim me ekspertë të prokurimit të armëve për t’u siguruar që Ukraina t’i ketë armët që i nevojiten, gjithçka që hidhet në letër të konkretizohet dhe kontratat të realizohen. “Pra, që industria të prodhojë, ata kanë nevojë për kontrata dhe ky ka qenë mesazhi nga industria gjatë gjithë rrugës dhe kjo është gjithashtu arsyeja pse ne filluam të angazhoheshim me industrinë vjeshtën e kaluar, kur pamë se kjo luftë po zvarritej, urgjente ishte rritja e prodhimit, që NATO të mos shterojë rezervat e saj, pasi u pa se shkalla e konsumit të municioneve është shumë më e lartë se shkalla e prodhimit dhe për këtë arsye duhet të prodhohet më shumë. Por kjo nuk është diçka që kemi zbuluar tani. Ne e kemi zbuluar këtë shumë muaj më parë, dhe për këtë arsye ne kemi qenë të angazhuar me industrinë, për një kohë të gjatë. Kontratat janë nënshkruar nga SHBA, Franca dhe Norvegjia ndër të tjera, por duhet të shpejtojmë dhe të bëjmë më shumë, dhe pikërisht, - tha shefi i NATO-s, - edhe ky takim shërbeu për të parë se si mund të mobilizojmë edhe më shumë dhe si mund ta përshpejtojmë prodhimin, duke koordinuar dhe përmirësuar procedurat, sepse projektet e mëdha të investimeve kërkojnë kohë, procedura burokratike që duhet bërë për të siguruar llogaridhënie, transparencë, që kontrata të jetë efektive. Pikërisht kjo është arsyeja pse ne po punojmë si NATO, me agjencitë tona dhe sistemet tona dhe drejtorët tanë të armatimit, ndërkohë që po punojmë me BE-në dhe drejtpërdrejt me Ukrainën, duke mbledhur ekspertët tanë për të ndjekur dhe parë se çfarë mund të bëjmë më shumë për të rritur prodhimin dhe në një mënyrë më të shpejtë”.

“NATO ka vendosur të ndihmojë Ukrainën me forcimin e kapacitetit të saj për të bërë prokurime dhe ky është një element i shumë hapave që ne po ndërmarrim së bashku për të siguruar që kemi municion të mjaftueshëm”, - informoi Sekretari i Përgjithshëm, pasi ato janë armë për të rimbushur rezervat e NATO-s por edhe për t’i dorëzuar Ukrainës. “Gjëja e fundit është që ne gjithashtu, natyrisht, kontaktojmë me partnerët ndërkombëtarë dhe për të parë se deri në çfarë mase ata mund të ndihmojnë për të ofruar mbështetjen e nevojshme direkte për Ukrainën, ose për të rimbushur rezervat tona”.

Robotët do të kryejnë 39% të detyrave në shtëpi deri në vitin 2033, thonë ekspertët

Brenda një dekade, rreth 39% e kohës së shpenzuar për punët e shtëpisë dhe kujdesin për të dashurit mund të automatizohen, thonë ekspertët.

Studiuesit nga Britania e Madhe dhe Japonia kërkuar 65 ekspertë të inteligjencës artificiale (AI) të parashikojnë sasinë e automatizimit në detyrat e zakonshme shtëpiake në 10 vjet.

Ekspertët parashikuan që blerjet ushqimore kishin të ngjarë të shihnin më shumë automatizim, ndërsa kujdesi për të rinjtë ose të moshuarit kishte më pak gjasa të ndikohej nga AI. Hulumtimi është publikuar në revistën PLOS ONE.

Studiuesit nga Universiteti i Oksfordit dhe Universiteti "Ochanomizu" i Japonisë donin të dinin se çfarë ndikimi mund të kenë robotët në punën e paguar shtëpiake: "Nëse robotët do të na marrin punët tona, a do të na nxjerrin të paktën edhe plehurat?", - pyetën ata.

Robotët 'për detyra shtëpiake', të tilla si pastrimi me fshesë me korrent, janë bërë robotët më të prodhuar dhe më të shitur në botë, vëzhguan studiuesit.

Ekipi pyeti 29 ekspertë të AI nga Britania e Madhe dhe 36 ekspertë të AI nga Japonia për parashikimet e tyre mbi robotët shtëpiake.

Studiuesit zbuluan se ekspertët meshkuj në Mbretërinë e Bashkuar prireshin të ishin më optimistë për automatizimin e brendshëm në krahasim me homologët e tyre femra, një situatë e kundërt në Japoni.

Por detyrat që ekspertët menduan se automatizimi mund të bënte ndryshonin: "Vetëm 28% e punës së kujdesit, duke përfshirë aktivitetet të tilla si mësimi i fëmijës suaj, shoqërimi i fëmijës suaj ose kujdesi për një anëtar më të vjetër të familjes, parashikohet të jetë i automatizuar", - tha Dr Lulu Shi, studiuese postdoktorale, Instituti i Internetit i Oksfordit.

Nga ana tjetër, teknologjia pritej të



shkurtoje 60% të kohës që shpenzojmë në blerjet ushqimore, thanë ekspertët.

Shumë parashikime në lidhje me automatizimin e detyrave shtëpiake janë bërë në të kaluarën dhe skepticizmi mund të jetë i justifikuar.

Parashikimet se robotët në dhjetë vitet e ardhshme do të na çlirojnë nga punët e shtëpisë kanë një histori të gjatë. Në vitin 1966, emisioni televiziv "Bota e së nesërme" raportoi për një robot shtëpiake i cili mund të gatonte darkë, të

shëtiste qenin, të kujdesej për fëmijën, të bënte pazar, të përziente një koktej dhe shumë detyra të tjera.

Nëse krijuesve të saj do t'u jepeshin vetëm 1 milion pound, pajisja mund të funksiononte deri në vitin 1976, transmeton lajmi...

Ekaterina Hertog, profesoreshë e asociuar në AI dhe Shoqëri në Universitetin e Oksfordit dhe një nga autorët e studimit tërheq paralele me optimizimin që ka rrethuar prej kohësh

makinat vetë-drejtoese: "Premtimi i makinave vetë-drejtoese, të qenit në rrugë, duke zëvendësuar taksitë, ka ekzistuar për dekada mendoj, e megjithatë, ne nuk kemi qenë në gjendje t'i bëjmë robotët të funksionojnë mirë, ose këto makina vetë-drejtoese të lundrojnë në mjedisin e paparashikueshëm të rrugëve tona. Shtëpitë janë të ngjashme në këtë kuptim".

Dr. Kate Devlin, lexuese në AI

& Society në King's College, Londër - e cila nuk ishte e përfshirë në studim - sugjeron se teknologjia ka më shumë gjasa të ndihmojë njerëzit, në vend që t'i zëvendësojë ata: "Është e vështirë dhe e shtrenjtë të bësh një robot që mund të bëjë detyra të shumta ose të përgjithshme. Në vend të kësaj, është më e lehtë dhe më e dobishme të krijosh teknologji ndihmëse që na ndihmojnë në vend që të na zëvendësojnë", - tha ajo.

Hulumtimi sugjeron se automatizimi i brendshëm mund të lirojë shumë kohë të shpenzuar në punë të papaguar shtëpiake. Në MB, burrat në moshë pune bëjnë rreth gjysmën e kësaj pune të papaguar sesa gratë në moshë pune, në Japoni burrat bëjnë më pak se një të pestën.

Barra joproporcionale e punës në familje mbi gratë ka një ndikim negativ në të ardhurat, kursimet dhe pensionet e grave, argumenton Prof Hertog. Rritja e automatizimit mund të rezultojë në barazi më të madhe gjinore, thonë studiuesit.

Megjithatë, teknologjia mund të jetë e shtrenjtë. "Nëse sistemet për të ndihmuar me punët e shtëpisë janë të përbalueshme vetëm për një nëngrup të shoqërisë kjo do të çojë në një rritje të pabarazisë, në kohën e lirë", - thotë Prof Hertog.

Ajo thotë se shoqëria duhet të jetë e gjallë ndaj çështjeve të ngritura nga shtëpitë plot me automatizim inteligjent, "ku një ekuivalent i Alexa-s është në gjendje të dëgjojë dhe të regjistrojë atë që po bëjmë dhe të raportojë".

"Unë nuk mendoj se ne si shoqëri jemi të përgatitur për të menaxhuar atë sulm masiv ndaj privatësisë".

NASA/ Reja e madhe e pluhurit e lëshuar nga Hëna e Tokës mund të lehtësojë ngrohjen globale

Lëshimi i vazhdueshëm i një rryme pluhuri nga hëna mund të ndihmojë në luftimin e ndryshimeve klimatike, Paola Iamunno

Lëshimi i një reje pluhuri nga hëna për të bllokuar rrezet e diellit që arrijnë në Tokë mund të zvogëlojë ngrohjen globale, por një strategji e tillë mund të kërkojë më shumë se një dekadë kërkime përpara se të zbatohet. Rreziqet e përfshira në një qasje të tillë për sa i përket mënyrës se si mund të ndikojë në bujqësi, ekosistemet dhe cilësinë e ujit në pjesë të ndryshme të botës janë gjithashtu të paqarta.

Vendosja e më shumë se 100 milionë tonë pluhur midis Tokës dhe Diellit për të bllokuar pjesërisht dritën që të arrijë planetin tonë është eksploruar më parë si një mënyrë për të luftuar ndryshimet klimatike. Grimcat e tilla pluhuri do të krijojnë një mburojë mbi Tokën, duke thithur energjinë e dritës ose duke shpërndarë grimcat e dritës, të njohura si fotone, larg Tokës.

Për ta arritur këtë, pluhuri do të duhej të vendosej 1.5 milionë kilometra larg Tokës, ku tërheqja gravitacionale e diellit dhe planetit tonë anulohet. Këtu, objektet qëndrojnë në një pozicion fikse të njohur si pika e parë e Lagranzhit, ose L1.

Grupe të ndryshme kërkimore kanë eksploruar vendosjen e pluhurit në L1, por energjia nga fotonet dhe grimcat e ngarkuara të nxjerra nga dielli, e njohur



si era diellore, mund ta shtyjë gradualisht pluhurin më larg nga pozicioni i tij i dëshiruar, gjë që do të kishte nevojë për korrigjim.

Tashmë, pas kryerjes së mijëra simulimeve kompjuterike, Benjamin Bromley në Universitetin e Utah dhe kolegët e tij kanë zbuluar se lëshimi i vazhdueshëm i një rryme pluhuri hënor direkt nga poli verior i hënës drejt L1 me një shpejtësi

prej 2.8 kilometra në sekondë mund të jetë një qasje më e mirë.

Në këtë skenar, simulimet sugjerojnë se çdo grimcë pluhuri e shtyrë kalon rreth pesë ditë, duke bllokuar rrezet e diellit të lidhura me Tokën, përpara se të shpërdahet në të gjithë sistemin diellor.

Duke marrë parasysh tërheqjen gravitacionale të diellit, Tokës dhe planetëve të tjerë, si dhe forcat jo gravitacionale si era

diellore, simulimet zbuluan se mbajtja e një mburoje pluhuri me një masë prej 1 milion ton afër L1 për një vit mund të zbehtë dritën e diellit në të gjithë Tokën me 1.8 për qind, ekuivalente me bllokimin e plotë të gjashtë ditëve të dritës së diellit.

El Niño i fortë mund ta bëjë vitin 2024 vitin e parë që kalojmë 1.5°C të ngrohjes.

Nëse qasja do të mbahej për një kohë të pacaktuar, ose derisa të futeshin masa të tjera për të hequr dioksidin e karbonit nga atmosfera e Tokës, kjo mund të kompensojë rritjen e niveleve të dioksidit të karbonit që ka ndodhur që nga revolucioni industrial, thotë Ben Kravitz në Universitetin e Indianës, Bloomington.

"Nëse kjo metodë funksionon, sigurisht që do të ishte efektive në uljen e temperaturës globale, por është e vështirë të thuhet nëse do të ia vlejte në lidhje me përpjekjet dhe burimet e përdorura", - thotë ai.

Ndërsa simulimet nuk modeluan përdorimin e ndonjë makinerie për të nisur pluhurin hënor drejt L1, ju mund të përdorni një pistoletë hekurudhore, e cila i shtyn gjërat përmes energjisë elektromagnetike, thotë Bromley. "Kjo do të ishte perfekte, sepse mund të ushqej nga disa kilometra katrorë panele diellore të vendosura pranë vendit të nisjes", - thotë ai. Megjithatë,

hijezimi i gjithë Tokës do të ketë efekte të pabarabarta në rajone të ndryshme, thotë Kravitz. "Temperatura, reshjet, erërat dhe shumë gjëra të tjera do të ndryshojnë (si rezultat i kësaj strategjie) dhe do të ndryshojnë ndryshe në vende të ndryshme", - thotë ai. "Këto ndryshime, natyrisht, do të përkthehen në efekte në bujqësi, ekosistemet dhe cilësinë e ujit."

Përpara se një strategji si kjo të mund të zbatohet, studime inxhinierike në shkallë të gjerë duhet të kryhen nga agjenci të shumta në vende të ndryshme dhe me konsideratë nga Kombet e Bashkuara, thotë Curtis Struck në Universitetin Shtetëror të Iowa-s.

Një çështje tjetër është se ndoshta do të kishte pasaktësi në lëshimin dhe shpërndarjen e pluhurit, të cilat do të kishin efekte të panjohura. "A do të kishte rënie të zgjeruara të mikrometeoriteve në Tokë dhe dëmtime të satelitoreve në orbitën e Tokës?" thotë Struck. "Kjo dhe shumë pyetje të tjera nuk janë studiuar në detajet e nevojshme". Për më tepër, shqyrtimi i një qasjeje si kjo nuk duhet të zëvendësojë përpjekjet tona për të ulur emetimet e karbonit në Tokë. "Ne duhet të vazhdojmë të reduktojmë gazrat serrë brenda atmosferës sonë, pavarësisht çdo gjëje", - thotë Bromley. "Zgjidhja jonë e mbrojtjes nëpërmjet pluhurit thjesht do të na blejë më shumë kohë."



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gjuha shqipe, tempulli ku ruhet shpirti i kombit

Më 21 shkurt, UNESCO shënon Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare. Diversiteti gjuhësor është çelës për ndërtimin dhe ruajtjen e shoqërive integrale.

Gjuhët përcjellin informacion dhe njohuri, duke promovuar në këtë mënyrë prosperitetin, ndryshimin shoqëror dhe zhvillimin. Shoqëritë shumëgjuhëshe ekzistojnë nëpërmjet gjuhëve të tyre, të cilat transmetojnë dhe ruajnë njohuritë dhe kulturat tradicionale në mënyrë të qëndrueshme.

Njohja dhe respektimi i diversitetit gjuhësor dhe kulturor janë thelbësore për bashkëjetesën paqësore. Termi gjuhë amtare zakonisht i referohet gjuhës së parë të mësuar, atë që flasin që në vegjëli. “Gjuha amtare është një gjuhë e mësuar nga folësi në fëmijërinë e hershme pa udhëzim zyrtar”.

Një kulturë paqeje mund të ndërtohet vetëm në një hapësirë ku secili ka të drejtë të përdorë plotësisht dhe lirisht gjuhën e tij amtare, në të gjitha rrethanat e ndryshme të jetës.

Gjuha, pasuria më e vyer e një kombi

Gjuha shqipe është pasuria më e vyer që na e kanë lënë në trashëgim me shekuj e brez pas brezi të parët tanë, edhe në periudhat me të errëta, kur nuk kishim alfabet e institucione shkollore, u munduan dhe e ruajtën atë si gjënë më të shenjtë, sepse ajo na identifikonte si komb. Gjatë historisë, ‘gjuha’ luajti rolin e instrumentit të formimit të identitetit, socializmit të individëve, grupeve shoqërore dhe faktorëve të integritetit socio-kulturor, pa marrë parasysh krahinën e besimet fetare, duke mbetur gjithnjë një ndër faktorët më të rëndësishëm të mbijetesës së popullit shqiptar.

Gjuha shqipe, si një tempull ku ruhet shpirti i kombit, në etapa të ndryshme i ka shërbyer popullit tonë. Prandaj rilindësit i kushtuan asaj vëmendjen më të madhe, sepse ishin më se të bindur se pa emancipim kulturor nuk ka as emancipim politik. Edhe pse ende nuk kishte një alfabet unik të gjuhës shqipe, të gjithë ata që krijonin alfabet, në rend të parë si synim e kishin ruajtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe nga gjuhët e huaja. Të gjithë rilindësit strumbullarin kryesor e konsideronin gjuhën e popullit. Pastërtia gjuhësore e shqipes ishte edhe një nga mënyrat për ta ruajtur identitetin etno-gjuhësor të kombit. Nëse kishte ndonjë ndarje etnolinguistike, ajo ishte vetëm një lloj rezistence mbrojtëse ndaj



valëve agresive të gjuhëve të pushtuesve nëpër shekuj.

Mirëpo, shekulli i ri, në vend që të sjellë përparim dhe zhvillim të gjuhës shqipe, si duket erdhi me një fatalitet për kombet e vegjël me rrezikun e depërtimit dhe përdorimit vend e pa vend të huazimeve, që e vërshojnë gjuhën tonë, kjo në dëm të fondit autokton.

Prishja e shijes së gjuhës si pasojë e globalizimit

Gjatë shekullit të kaluar kishte një përpjekje për të folur e shkruar në gjuhën standarde, por me ardhjen e demokracisë e deri në ditët e sotme, gjuha letrare shqipe fillon të bastardohet nga të gjitha anët deri në palcë.

Nga ana tjetër, tani, kur bota po globalizohet, lind pyetja se çfarë do të ndodhë me gjuhët e popujve të vegjël?

Si do të mbrohet gjuha shqipe nga kjo pandemi gjuhësore?

Ne ecim rrugëve dhe qendrave tregtare të mbytur nga shkëlqimi i

fjalëve angleze, greke, italiane etj. Muajt e verës, në çdo ambient publik, e gjen veten në çdo cep të botës veç në Shqipëri jo.

Shqiptarë që nuk flasin ‘gjuhën e nënës’, ‘thank you, efharisto, grazie, danke’, ne kërkojmë fjalë të gjuhës amtare si të huaj. Fëmijë të lindur në Shqipëri por që jetojnë jashtë trojeve shqiptare nuk mundin të artikulojnë qartë gjuhën shqipe dhe këtu problem nuk janë ata, por prindërit e tyre me neglizhencën ndaj identitetit të tyre po humbasin çdo ditë dhe më shumë respektin për veten.

A do të kemi në të ardhmen gjuhë amtare?

Kriza e identitetit po përhapet me shpejtësi si një sëmundje ngjitëse dhe po i prek të gjitha grupmoshat. Kjo krizë i përfshin të gjitha shtresat e shoqërisë, si individë dhe grupe të ndryshme, madje edhe kombe të tëra. Kriza e identitetit është aq e përhapur në të gjitha poret

e shoqërisë moderne, perëndimore dhe lindore, sa që nuk njihet më si një rrezik i mundshëm, por si pjesë e jetës së përditshme. Për fat të keq, populli shqiptar nuk është më pak i prekur nga ky fenomen global. Tani ndodhemi para faktit, gjuha shqipe në shumë familje nuk është më gjuhë amtare. Në familjet shqiptare fëmijët me motrat dhe vëllezërit, si edhe me moshatarët e tyre, komunikojnë në gjuhët e vendeve respektive...

Për fat të keq, populli ynë nuk është më pak i prekur nga ky fenomen global dhe shkaku qëndron në globalizimin në rritje të rinisë naive në krahasim me të moshuarit.

Të rinjtë janë dorëzuar plotësisht para globalizimit, madje për ta të moshuarit me kokëfortësi përfshihen tek kategoria e “të pamoderuarve”.

Nga ana tjetër, interneti ka sjellë shumë gjëra pozitive dhe bota sot është në pëllëmbë të dorës, falë internetit,

Gjuha shqipe është pasuria më e vyer që na e kanë lënë në trashëgim me shekuj e brez pas brezi të parët tanë, edhe në periudhat me të errëta, kur nuk kishim alfabet e institucione shkollore, u munduan dhe e ruajtën atë si gjënë më të shenjtë, sepse ajo na identifikonte si komb.

diversiteti dhe pluralizmi midis njerëzve është zhdukur pothuajse plotësisht dhe individualizmi po bëhet një e kaluar. Zakonet, tradita gojore dhe e shkruar, kostumet dhe shumë tipare të tjera të larmisë kulturore, dita-ditës po zbehen dhe njerëzit po bëhen kopje “origjinale”.

Kush do ta mbrojë gjuhën shqipe?

Kultura e gjuhës sonë nuk duhet të kufizohet dhe atë t’ia ngarkojmë vetëm mësuesve dhe lëndës së gjuhës shqipe, por atë duhet ta shtrijmë edhe në shtyp, në media, institucione e kudo.

Shkrimtari ynë, Asdreni, para 115 vjetësh do të shfaqte skepticizmin e tij drejt portretizimit të gjuhës shqipe: “Që ta shkruash gjuhën shqipe, s’është punë e rëndë, por s’është as e lehtë, por këtë mund ta arrijmë, ta shkruajmë gjuhën tonë mirë e bukur, vetëm duke punuar për këtë sistematikisht e me seriozitet të plotë”. Vetëm kështu mund ta mbrojmë gjuhën tonë në epokën e globalizimit.

Skënderbegasi Gjergj Titani, ushtaraku madhor dhe shkencëtari i përkushtuar

Gjergj Titani, një nga ushtarakët madhor të vendit, lindi në vitin 1941. Pasi kryen arsimin fillor në vendlindje, Gjergji, në vitin 1950, nis studimet në shkollën ushtarake “Skënderbej”, shkollë që në një farë kuptimi, kishte kohë që e priste atë, pasi ishte vazhduese dhe trashëguese e drejtpërdrejtë e luftës nacionalçlirimtare. Tani Gjergji, i burrëruar dhe i mençuruar para kohe, gjen shokë moshatarë, me qëllime e vizione të qarta për perspektivat që u dilnin përpara. Në këtë mjedis, Gjergji skënderbegas, farkëton karakterin, sipas parimeve diogjenike se pasuria që duhet të mbajë me vete njeriu, është drejtësia, edukata, vullneti dhe guximi. Por mbi të gjitha, ai këtu bëri miq që nuk iu ndanë tërë jetën. Ai në bankat e kësaj shkolle rrënjosi njëherë e mirë mendimin filozofik se miqësia është më tepër se sa shfaqja e virtytit, ajo është vetë virtyti. Me këto vlera njerëzore, Gjergji, duke shpalosur gjithçka të mirë që mori në këto vite, si në ditë të lumtura, ashtu dhe kur fati i ktheu krahët, u shndërrua në simbol, në një figurë emblematike, për të gjithë vëllazërinë e atyre që studioan në të papërsëritshmen shkollë “Skënderbej”. Në vitin 1952 Gjergji hyri në shkollën e Bashkuar dhe pasi u titullua oficer në vitin 1954, dërgohet për të ndjekur më tej studimet e larta në shkollën e Artilerisë Bregdetare “Flamuri i Kuq”, në Riga të Letonisë, në ish-Bashkimin Sovjetik, studime të cilat i përfundon në vitin 1959 në shkollën e Flotës Detare “Kirov”, buzë detit Kaspik. Të gjithë skënderbegasit që studioan në Bashkimin Sovjetik të asaj kohe, kanë lënë përshtypjet më të mira dhe kanë fituar zemrat e popullit të atij vendi të paanë. Por interesat e gjera kulturore, artistike, letrare dhe deri sportive të Gjergj Titanit, kanë mbetur proverbiale. Nuk ka muze, teatër, opera, kinema, stadium, bibliotekë a vend historik që të mos ketë frekuentuar ai, gjë që nuk kishte sesi të mos ndikonte fuqishëm në krijimin e një personaliteti të jashtëzakonshëm dhe imponues. Me këtë bagazh intelektual në mendje dhe me Enciklopedinë e madhe ruse ndër duar, ai kthehet në atdhe dhe emërohet në një bateri bregdetare të largët, në Kepin e Rodonit. Cilësitë e këtij oficeri të ri, ranë shpejt në sy, aq sa arriti të fitonte dashurinë e krerëve të shtetit, ndaj nisi rruga e tij e ngjitjes, rrugë e cila pati si stacione kryesore Sazanin, Tiranën, Durrësin, Fushë-Krujën, Fierin, Vlorën, duke kryer detyra të rëndësishme, deri në Shtatmadhori dhe shef i Shtabit të Korpusit. Në vitin 1969 ai kreu dhe Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, me rezultate të shkëlqyera dhe emri i tij u bë i njohur



kudo. Duke dëshmuar vetëm për kohën që ai ka shërbyer në Brigadën e katërt të Mbrojtjes Bregdetare në Durrës, të drejtuar me aq talent nga komandanti i saj Xhemal Zeneli, mund të them se edhe sot e kësaj dite, kujtohen me nderim, aftësitë profesionale, kultura e lartë, përkushtimi në detyrë, iniciativa e zgjuar dhe dashuria për shokët dhe vartësit e shefit të Shtabit Gjergj Titani. Me energji përherë në shpërthim, dhe me një shpirt të madh krijues, ai ishte prekursori i çdo stërvitjeje, i punës për kualifikimin e shtabeve, i nxitjes së vetëveprimtimit të reparteve, i ndërtimit të poligoneve a kabineteve të sofistikuar etj. Gjergji kishte arritur të krijonte marrëdhënie tepër të ngrohta me shokët e terrenit. Ai, ashtu si edhe sot, ka qenë i pavarur në mendime, por tërësisht i

varur nga dashuria për njerëzit, shkollën “Skënderbej”, ushtrinë dhe Shqipërinë. Kudo që ai shkonte, gjë që e ruan të pacenuar, Gjergji sillte gëzim dhe optimizëm.

...Më 17 gusht të vitit 1977 Gjergji arrestohet dhe dënohet e ri dënohet me tetëmbëdhjetë vjet burg politik. Në kundërshtim me Dostojevskin e tij të adhuruar, ai vetë nuk dëshiron të numërojë hidhërimet e tij. Si një shekspirian i vërtetë, ai u tregua madhështor, duke vuajtur urtësisht. Por shpirti i tij i lënduar e shpreh revoltën e brendshme me vargje tronditëse: “Ku bën ligjin marrëzia/ Ku përleshet zemërimi/ Ja qelia! Ku veçuar rri si murgu/ Ku veç bindjet ke melhem/ Ky është burgu!”. Gjergji gjen ndonjëherë pak qetësi, mes gjeneralëve

dhe heronjve të luftës që paradoksalisht dhe tragjikisht, patën fatin e tij dhe ndodhte t’i vdisnin ndër duar. Po kush i shëron plagët e zemrës, kur sheh sa heq e gjora nëna e tij që e ndjek pas, majë kamionëve, me trastat me ushqime? Triumfi i demokracisë, ashtu si për shumë të tjerë, solli më 30 prill të vitit 1990, edhe për Gjergjin, lirinë e ëndërruar, të cilën ai e kishte portretizuar: “Ndjenjë njerëzore./ Zjarr që ndizet nga lashtësia/Shqipe që fluturon në hapësirë/ Liria!” Sa flaku prangat, Gjergji me energji të shumëfishuara, që buronin nga përcaktimi i Volterit se “Forca më e madhe është tek një zemër e pafajshme”, aktivizohet vrullshëm në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut. Ai është zgjedhur nënkryetar i Forumit

Mbarëkombëtar të Intelektualëve të Shqipërisë në Stamboll, drejtor administrativ i Fondacionit “Dhora Leka”, sekretar i shoqatës “Miq të Pushkinit”, kryetar i shoqatës “Miq të Zhukovit” dhe ishte anëtar i kryesisë së shoqatës kombëtare “Skënderbegasi”. Nuk ka veprimtari brenda vendit, ku të mos dëgjohej zëri burrëror dhe i vendosur i Gjergj Titanit, ashtu sikurse ky zë është dëgjuar me respekt të veçantë në Rusi, Holandë, Itali, Greqi, Rumani, Bullgari, Jordani, Hungari, Turqi, SHBA, Marok, Suedi, Belgjikë, Maqedoni etj. Është autor i shumë artikujve, referateve dhe kumtesave. Ka shkruar e botuar librin e parë me poezi “Metaforat e dhembjeve” (përkthyer në Rumani, Çeki, Holandë, Poloni etj.). Ka vijuar me “Balada e shpresave” (poezi) dhe librin historiko – publicistik me bashkautor “Personalitete ushtarake shqiptare në vite”, librin “Lufta Italo – Greke” dhe “Krijuesi i organeve të rendit shqiptar”. I palodhur Gjergji është treguar në fushën e vështirë të përkthimeve, duke përkthyer me një gjuhë korrekte e të pastër “Historia e marrëdhënieve shqiptaro – sovjetike”, “Kujtime dhe meditime” të Zhukovit në dy volume, “Jeta ime” e Leon Trockit, Mareshallin Vasiljevskij, “Nga partizan shqiptar deri në gjeneral sovjetik”. Për gjithë veprimtarinë e tij, Gjergj Titani është dekoruar me urdhra e medalje nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. I janë akorduar tri të tilla nga presidentët e Rusisë Boris Jelcin dhe Vladimir Putin dhe është laureuar nga komanda e Korpusit të Tretë të Selanikut, Akademia e Mbrojtjes bullgare “Georgi Rakovski” dhe Universiteti “Vasil Levskij”. Në vitin 1996 ai fiton gradën “Doktor i shkencave”, kurse më pas atë të “Profesorit të Asociuar, Doktor”. Universiteti i Kembrixhit e ka shpallur atë një nga intelektualët e shquar të shekullit të njëzetë, duke e përfshirë në librin e tij të nderit. Gjergji, me të përpjetat dhe të tatëpjetat e jetës së tij, mban në miniaturë, tërë historinë e Shqipërisë qysh nga fillimi i luftës së dytë botërore, ndaj dhe e meriton adhurimin e të gjithëve. Ai u nda nga jeta, por mbi të gjitha, mbeti një ushtar i përhershëm dhe besnik i Atdheut të vet dhe do të nderohet e kujtohet me respekt...

SOLIDARITETI I BE-SË ME UKRAINËN

Slava Ukraini - Një vit rezistencë e Ukrainës

Sulm kundër paqes dhe demokracisë

Një vit më parë, më 24 shkurt 2022, forcat ruse filluan një pushtim të plotë të Ukrainës. Deri më tani, lufta e agresionit të Rusisë ka përhapur vdekjen dhe shkatërrimin në Ukrainë.

“Ukraina është bërë qendra e kontinentit tonë. Vendi ku mbahen vlerat tona, ku mbrohet liria jonë, ku shkruhet e ardhmja e Evropës”, - Ursula von der Leyen, Presidente e Komisionit Evropian.

Kur trupat ruse sulmuan Ukrainën, ekzistonte frika e përhapur se vendi nuk do të ishte në gjendje t'i rezistonte sulmit të pushtuesve për një kohë të gjatë dhe do të binte. Ajo që ka ndodhur gjatë vitit të kaluar është pikërisht e kundërta. Trimëria legjendare e popullit ukrainas tronditi botën dhe rezistenca kundër pushtuesit vazhdon dhe mbështetet në mënyrë të palëkundur nga Bashkimi Evropian.

Për shkak të sulmeve barbare të Rusisë ndaj infrastrukturës dhe popullsisë civile të Ukrainës, shumë ukrainas janë detyruar të gjejnë strehim në bodrume pa energji elektrike, gaz ose ujë të rrjedhshëm. Përveç kësaj, shkollat në të gjithë vendin janë bombarduar rëndë, duke i ndaluar fëmijët të ndjekin mësimin.

Ndikimi i luftës në jetën e përditshme Në fillim, kur bombat e Rusisë filluan të binin si shi mbi qytete dhe zona në të gjithë Ukrainën, civilët u përpoqën maksimalisht për të ruajtur një pamje normale. Por disa muaj pas luftës, veprimtaritë e zakonshme të jetës së përditshme, të tilla si shkuarja në një furrë buke, lokale ose thjesht marrja e fëmijëve në shkollë, nuk u bënë më të mundshme mes dhunës së pandërprerë.

Duke nderuar ukrainasit kurajoz Numrat dhe statistikat nuk janë të mjaftueshme për të treguar historinë e plotë. Për të kuptuar më mirë situatën në terren, ne kemi mbledhur dëshmi nga disa prej atyre që mbajnë peshën më të madhe të mizorive të Rusisë:

Të lindësh dhe të jesh nënë gjatë luftës

Kur filloi lufta, Julia ishte 36 javë shtatzënë. Ishte e vështirë për të që të vendoste për evakuimin në një fazë kaq të vonë të shtatzënisë. Dhe ajo nuk donte të linte burrin e saj, i cili u bashkua mbrojtjes territoriale. Ajo donte që ai të mbante fëmijën e tyre të porsalindur në krahë të paktën një herë.

Qëndrimi me Ukrainën për aq kohë sa duhet

Që nga dita e parë e luftës së pa-justifikuar dhe të paligjshme të Rusisë kundër Ukrainës, Bashkimi Evropian dhe aleatët e tij kanë marrë vendimin



Andriy Andriyenko/SOPA Images/LightRocket and Chris McGrath/Getty Images

evropian të energjisë elektrike, akses në roaming, mbrojtjen e fëmijëve.

Ndikimi i luftës në Evropë dhe më gjerë Lufta e agresionit të Rusisë ka efekte globale, të cilat po prekin veçanërisht më të cenuarit. Dëmi i shkaktuar në infrastrukturën e Ukrainës ka pasur një ndikim të rrezikshëm në sigurinë ushqimore për miliona njerëz në mbarë botën.

Si e tillë, ndihma do të vazhdojë të rrjedhë në Kiev gjatë kohëzgjatjes së luftës dhe më gjerë.

Nga ana tjetër, Bashkimi Evropian do të mbajë presionin ndaj qeverisë ruse përmes një përzierjeje diplomacie dhe një grupi të rreptë sanksionesh.

Bashkëpunimi i ngushtë politik

Kolegji i Komisionerëve Evropian viziton për herë të parë Ukrainën. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, udhëtoi për në Kiev, më 2 shkurt 2023, e shoqëruar nga 15 komisionerë, për takimin e parë mes Kolegjit të Komisionerëve të BE-së dhe qeverisë ukrainase, duke dërguar një sinjal të fortë të angazhimit të palëkundur të BE-së për të ndihmuar Ukrainën.

Bashkëpunimi politik me Ukrainën është më i fortë se kurrë: me punën e vazhdueshme për anëtarësim, akses në tregun e vetëm, sinkronizimi me rrjetin

evropian të energjisë elektrike, akses në roaming, mbrojtjen e fëmijëve.

Ndikimi i luftës në Evropë dhe më gjerë

Lufta e agresionit të Rusisë ka efekte globale, të cilat po prekin veçanërisht më të cenuarit. Dëmi i shkaktuar në infrastrukturën e Ukrainës ka pasur një ndikim të rrezikshëm në sigurinë ushqimore për miliona njerëz në mbarë botën.

Bashkimi Evropian po ndërmerr hapa për të siguruar që siguria globale e ushqimit të rikthehet përmes bashkëpunimit ndërkombëtar. Ajo po mobilizon gjithashtu ndihmën dhe mbështetjen humanitare për fermerët më të prekur.

Përgatitja e një të ardhmeje më të ndritshme për Ukrainën Solidariteti i BE-së me Ukrainën

dhe popullin e saj do të mbetet i palëkundur. Ne jemi thellësisht të vetëdijshëm se në lojë nuk është vetëm e ardhmja e popullit ukrainas, por e ardhmja e të gjithë kontinentit evropian. Liria dhe demokracia janë në thelb të frymës evropiane, dhe për to nuk do të bëjmë kurrë kompromis.

Ne besojmë fuqishëm se Ukraina do të dalë fitimtare sepse drejtësia është në anën e saj. Dhe kur të vijë ajo ditë, Bashkimi Evropian do të jetë aty duke qëndruar krah për krah me Ukrainën për të ndihmuar vendin të ngrihet në këmbë dhe të mbështesë rimëkëmbjen dhe rindërtimin e tij.

Ne kemi vullnetin politik për t'i kërkuar përgjegjës autorët e krimeve që po kryhen, përfshirë edhe krimin e agresionit. Ndërsa vazhdojmë të mbështesim punën e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, ne jemi të gatshëm të punojmë me komunitetin ndërkombëtar për ngritjen e një tribunali ndërkombëtar ad hoc ose një tribunal të specializuar “hibrid” për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e agresionit të Rusisë. Për të ndihmuar në koordinimin e mbledhjes së provave, ne do të krijojmë një Qendër Ndërkombëtare për Ndjekjen e Krimit të Agresionit në Ukrainë në Hagë.

Historia #40. Ditari i luftës i një gruaje

Chernihiv 17 gusht 2022

Historia e Nina Biletska, e cila mbajti një ditar gjatë armiqësive aktive në Chernihiv.

Lufta filloi në orën 4 të mëngjesit. Kjo luftë tinëzare, vrastare. Rusia hyri në luftë kundër Ukrainës paqësore. Fillimisht bombarduan të gjitha objektet ushtarake dhe më pas ndërtesat e banimit, shkollat dhe kopshtet.

Dhe kur ushtria jonë filloi të luftonte, rusët filluan të vrisnin civilë. Ne jemi ulur në bodrum: 2 fëmijë, 3 zonja të moshuara dhe 2 të rritur që po na ndihmojnë të mbijetojmë në këtë kohë të tmerrshme.

7 mars. Ushtria jonë zbrapsi sulmet e armikut gjatë gjithë mëngjesit. Pastaj pati një pushim. Nuk ka energji elektrike, gaz, internet. Nuk ka asnjë lidhje me botën e jashtme. Është dita e 12-të e luftës aktuale.

Gjysma e qytetit është shkatërruar, Novoselivka është shkatërruar. Qendra e qytetit është e shkatërruar. Njerëzit që kanë mundësi të largohen e bëjnë këtë. Rusët po qëndrojnë në Rivnopillia midis shtëpive dhe godasin rrethet tona. Zot, kur do të përfundojë e gjithë kjo?

Natën e 9, 10 dhe 11 marsit, zonat Kukushanka, Rakhmatulin, Malinovskiy, Shevchenko, Kryvonos u bombarduan. Shtëpitë digjeshin nga larg. Stadiumi u bombardua mbrëmjen e 11 marsit.

Rusët po e shkatërrojnë qytetin hap pas hapi. Ata shkatërruan një qark dhe morën tjetrin. Ushtarët rusë kanë një ide shumë të shtrembëruar për të vërtetën. Vetëm pak e kuptojnë se populli ukrainas nuk është armiku i tyre.

Natën e 12-13 marsit u granatua një konvikt grash, u vranë gra dhe fëmijë. Shumë shtëpi në rrugën tonë kishin xhamat e thyer dhe një shtëpi u dogj. Granatimet vazhduan gjatë gjithë ditës, natën u hodh një bombë në bazën ushtarake.

14 mars. Sasha po gatuan borscht, dhe Vika po gatuan qull. Granatimet vazhdojnë në zonat Kuku-shanka, Odintsov dhe Malinovskiy. Ndoshta nuk ka mbetur asnjë hapësirë jetese. Kam shume frikë për

fëmijët. Por ata po argëtohen dhe nuk u kushtojnë rëndësi këtyre shpërthimeve.

Ka 4 ditë që nuk mund të dalim jashtë. Granatimet vazhdojnë nga mëngjesi i hershëm deri në orët e vona të mbrëmjes. Mbrëmjen e djeshme, një aeroplan bombardoi një rrugë aty pranë, shtëpitë po digjeshin dhe njerëzit e varfër bërtisnin.

17 mars. Në rrugën Dotsenko, njerëzit qëndronin në radhë për bukë. Ata u goditën nga një predhë, 15 persona vdiqën, shumë u plagosën. Më 18 mars, predha goditën një ndërtesë shumëkatëshe.

Sot Sasha shkoi në banesë. Fëmijëve u solli aku-llore, për të cilën kishin disa ditë që e kërkonin Shën Nikollën. Nuk na bombarduan nga avionët atë natë. Dhëntë Zoti që nata tjetër të jetë e njëjtë. Gjatë pushtimit ndërmjet granatimeve, pastrojmë pak oborrin, presim pemët dhe mbledhim copëza.

“Presidentë të Rusisë dhe Bjellorusisë, mallkuar ju. Mund ta përjetoni atë që populli im ukrainas po përjeton tani. Ju dhe fëmijët tuaj le të frikësoheni nga çdo zhurmë dhe mos t’ju ndihmojë asnjë para. Mund të jetoni në një birucë si minjtë.”

Sot është tashmë 1 Prill. Nata ishte e qetë, pati një shpërthim diku larg. Ka rënë shi gjatë gjithë ditës, ndaj mbledhim ujë në të gjitha enët bosh. Fëmijja Masha erdhi dhe na argëtoi me historitë e saj. Ndoshta për herë të parë ndihemi të paktën pak të sigurt dhe të qetë. Njerëzit thonë se fashistët rusë po tërhiqen pak nga pak. Dhëntë Zoti që të ikin dhe të mos kthehen më.

2 Prill. Sot është dita e parë e heshtjes. Nuk ka bomba, raketa, grada apo predha. Unë dhe Vika copëtuam dru zjarri dhe fqinji riparonte dritaret e njerëzve. Vullnetarët sollën ushqim. Por ende nuk ka asnjë lidhje me botën e jashtme. Më 8 prill, fëmijët shkuan në banesën e tyre dhe e kaluan natën atje. Të nesërmen Sasha kaloi me makinë dhe ne pimë kafe. Fëmijët më në fund i ngarkuan telefonat e tyre dhe ne mësuam më shumë për tmerret e luftës. Është thjesht e pamundur të falësh.



Yurii Rylchuk/Ukrinform/Future Publishing and Van der Stockt for Le Monde/Getty Images

Plani Industrial i Marrëveshjes së Gjelbër: Sigurimi i udhëheqjes së teknologjisë së pastër të BE-së

Eurodeputetët thonë se BE-ja duhet të udhëheqë në teknologjitë e energjisë së pastër, të përmirësojë bazën e saj industriale dhe të prodhojë vende pune me cilësi të lartë dhe rritje ekonomike për të arritur objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër.

Në një rezolutë të miratuar, në përgjigje të “Planit Industrial të Marrëveshjes së Gjelbër” të Komisionit për Epokën Neto Zero, eurodeputetët i bëjnë thirrje Komisionit të punojë në planet për të ri-vendosur, zhvendosur dhe rifitur industrinë në Evropë. Ata theksojnë rëndësinë e rritjes së fuqisë prodhuese të BE-së në teknologjitë strategjike si energjia diellore dhe e erës, pompat e nxehtësisë dhe bateritë.

Ata kërkojnë shkallëzimin dhe komercializimin e përmirësuar të teknologjive strategjike për të kapërcyer hendekun midis inovacionit dhe vendosjes së tregut. Sipas eurodeputetëve, nevojiten gjithashtu procedura të shpejta dhe të parashikueshme të lejeve për të ngritur projekte të reja për të vendosur burimet e rinovueshme të energjisë së pastër të jetë e mundur.

Objektivi i përgjithshëm i politikës së BE-së duhet të jetë sigurimi i liderit evropian në teknologjitë e energjisë së pastër dhe përmirësimi i bazës industriale ekzistuese të Evropës duke ndihmuar në transformimin e saj për të prodhuar vende pune me cilësi të lartë dhe rritje ekonomike për të arritur qëllimet e Marrëveshjes së Gjelbër. Për ta arritur këtë, thonë eurodeputetët, BE-ja duhet të marrë masa për të përshtetur kapacitetet prodhuese për energji



të përballeshme, të sigurt dhe të pastër të destinuar për përdorim nga industria dhe për të rritur kursimin e energjisë dhe masat e efikasitetit të energjisë.

Eurodeputetët theksojnë gjithashtu rëndësinë e aksesit të sigurt në lëndët e para kritike për të arritur transformimet ekologjike dhe dixhitale të BE-së. Projektet strategjike evropiane kanë nevojë për leje më të shpejta dhe më transparente, sipas eurodeputetëve.

Fondi Evropian i Sovranitetit

Një fond i ardhshëm i Sovranitetit Evropian duhet të synojë të shmangë fragmentimin e shkaktuar nga skemat e pakoordinuara të ndihmës shtetërore dhe të sigurojë një përgjigje efektive ndaj krizës, këmbëngulin eurodeputetët. Fondi duhet të forcojë autonominë strategjike të BE-së dhe tranzicionin e gjelbër dhe dixhital, të integrohet në buxhetin aktual afatgjatë të BE-së dhe të mobilizojë investimet private.

Rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore duhet gjithashtu të thjeshtohen dhe të lejojnë fleksibilitet, por kjo duhet të jetë e synuar, e përkohshme,

proporcionale dhe në përputhje me objektivat e politikës së BE-së. Eurodeputetët qëndrojnë me vendosmëri kundër çdo përpjekjeje për t'i bërë rregullat e ndihmës shtetërore më fleksibël pa ofruar një zgjidhje evropiane për të gjitha vendet anëtare që nuk kanë kapacitete të mëdha fiskale për të financuar mbështetjet masive të ndihmës shtetërore.

Ligji i SHBA-së për Reduktimin e Inflacionit

Eurodeputetët duan që Komisioni të mbajë një qëndrim më të fortë në trajtimin e konkurrencës së padrejtë globale të shkaktuar nga ndihma e pajustificuar shtetërore. Ata shprehin shqetësimin për dispozitat në Aktin e SHBA-së për Reduktimin e Inflacionit (IRA) që diskriminojnë kompanitë e BE-së. Komisioni duhet të punojë me SHBA-në për të siguruar që BE-ja të mbulohet nga përjashtimet e parashikuara në IRA për vendet me një bashkëpunim të tregtisë së lirë dhe që produktet evropiane të kenë të drejtë për kredi tatimore si homologët e tyre amerikanë.

“Arsimi nuk mund të presë”: Team Europe premtion 313 milionë euro për arsimim më të mirë për fëmijët në krizë dhe për të mos lënë askënd pas

Komisioni Evropian dhe Shtetet Anëtare të BE-së, si Team Europe, u zotuan të investojnë 313 milionë euro në ‘Education Cannot Wait’ (‘Arsimi nuk mund të presë’), fondi global i Kombeve të Bashkuara që ndihmon për të arritur fëmijët e cenueshëm të prekur nga kriza me mbështetje arsimore të menjëhershme dhe afatgjatë. Ky është kontributi më i madh për Fondin.

Bashkimi Evropian dhe ‘Education Cannot Wait’, të dy promovojnë aksesin në arsim të cilësisë së lartë për fëmijët më të mbetur pas dhe kërkojnë t’i bëjnë investimet në arsim më efektive dhe të qëndrueshme, duke kapërcyer hendekun midis ndërhyrjeve humanitare dhe zhvillimit, në përputhje me angazhimet e Samiti i Transformimit të Arsimit.

Financimi përmes ‘Arsimi nuk mund të presë’ plotëson mbështetjen e tjera të BE-së për të promovuar arsim cilësor për fëmijët dhe të rinjtë në emergjencë dhe kriza të zgjatura dhe për të rritur elasticitetin e sistemeve arsimore në vendet partnere. Investimet e BE-së në arsim në vendet e brishta gjatë periudhës 2021–2027 do të arrijnë në 3.2 miliardë euro, nga buxheti i BE-së.

‘Education Cannot Wait’ (ECW) është fondi global i Kombeve të Bashkuara për edukimin në raste urgjente dhe kriza të zgjatura. Aktiv në 31 vende, ‘Edukimi nuk mund të presë’ ka mbështetur tashmë 6.9 milionë fëmijë dhe të rinj.

Gjermania është kontribuuesi i vetëm më i madh në ‘Education Cannot Wait’, me 210 milionë euro për periudhën 2023–2026. Shtetet e tjera anëtare që kontribuojnë në premtimin e përgjithshëm të Ekipit të Evropës janë Danimarka, Finlanda, Irlanda, Spanja dhe Italia. Komisioni ka financuar ‘Education Cannot Wait’ me 27.5 milionë euro që nga fillimi i tij dhe tani do të vërë në dispozicion 25 milionë euro shtesë për 2023–2027.

Bashkimi Evropian mbetet fuqishëm i përkushtuar për të përshtetur progresin drejt Objektivit 4 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG 4) për arsimin cilësor. Institucionet e BE-së dhe Shtetet Anëtare së bashku kontribuojnë më shumë se gjysmën e të gjithë ndihmës globale për arsimin, duke mbështetur sektorin e arsimit në më shumë se 100 vende në mbarë botën.

“BE-ja, si kampione e arsimit, është e përkushtuar të investojë më shumë dhe më mirë në arsim, përfshirë në emergjencë dhe kriza, në përputhje me angazhimet e marra në Samitin e Transformimit të Arsimit. ‘Arsimi nuk mund të presë’ është një partner kyç në arritjen e 222 milionë fëmijëve të goditur nga kriza në botë. Kam kënaqësinë të konfirmoj se, duke pasur parasysh urgjencën, zotimi prej 25 milionë euro i Komisionit Evropian do të vihet në dispozicion që nga ky vit”, Jutta Urpilainen, Komisionere për Partneritete Ndërkombëtare.



Aleanca Globale e BE-së për Ndryshimet Klimatike: Arritjet nuk i plotësuan ambiciet

Aleanca Globale e Ndryshimeve Klimatike, e krijuar nga BE në 2007 për të mbështetur vendet e varfra në zhvillim që t’i përgjigjen ndryshimeve klimatike, nuk i përmbushi premtimet e saj. Ky është mesazhi i një raporti të ri të Gjykatës Evropiane të Auditorëve. Auditorët gjetën pak prova për të sugjeruar se nisma kishte rritur elasticitetin e vendeve ndaj ndryshimeve klimatike. Për sa i përket efikasitetit, veprimet e përfunduara kishin dhënë përgjithësisht rezultatet e tyre, por ndonjëherë me një kosto të lartë. “Ne zbuluam se nisma e Aleancës për Ndryshimet Klimatike Globale kishte më pak ndikim sesa pritej dhe se zhvendosja e pritshme nga ndërtimi i kapaciteteve drejt veprimeve më konkrete që mbështesin drejtpërdrejt popullsinë nuk ishte sistematike”, - tha Hannu Takkula, anëtar i ECA-s. i cili drejtoi auditimin. “Ne mendojmë se Komisioni Evropian duhet të fokusohet tek ata që janë më të prekur nga ndryshimet klimatike dhe të përfshijë mësimet e nxjerra si në veprimet e ardhshme të ndryshimeve klimatike, ashtu edhe në iniciativat e ardhshme të ndihmës”. Aleanca Globale e Ndryshimeve Klimatike e bazoi qasjen e saj në dy shtylla: nxitja e dialogut dhe shkëmbimi i njohurive, dhe ofrimi i mbështetjes



teknike dhe financiare për masat e përshtatjes, zbutjes dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Auditorët zbuluan se iniciativa nuk matu përmirësimet në situatat e përfituesve dhe as nuk u fokusua mjaftueshëm në nevojat e atyre që prekeshin më shumë. Ndihma nuk arrinte gjithmonë të marrësit e synuar të cenueshëm: për shembull, disa veprime

përfshinin aktivitete që adresonin në mënyrë specifike nevojat e grave dhe disa aktivitete të tjera ishin të papërballeshme për familjet më të varfra. Veprimet pilot të suksesshme gjithashtu mund të ishin rritur për të mundësuar që më shumë njerëz të përfitojnë. Gjatë gjithë jetëgjatësisë së saj, Aleanca Globale e Ndryshimeve Klimatike nuk

tërhoqi fondet shtesë të pritura nga vendet e BE-së dhe sektori privat. Pavarësisht nga ky boshllëk i konsiderueshëm financiar, Komisioni nuk i rishikoi kurrë objektivat e tij fillestare ambicioze. Për më tepër, në fazën e dytë (Aleanca Globale e Ndryshimeve Klimatike +, 2014–2020), kriteret e përdorura nga Komisioni për shpërndarjen e parave çuan në shpërndarjen proporcionale më të vogël të mbështetjes për vendet më të cenueshme.

Komisioni nuk ka analizuar mjaftueshëm arsyeshmërinë e kostove të buxhetuara të shumicës së veprimeve të ekzaminuara nga auditorët. Për shembull, kostot e menaxhimit të veprimeve ndryshonin gjerësisht dhe ishin veçanërisht të larta në rajonin e Paqësorit. Mund të kishte pasur kursime me një analizë më të detajuar të kostove, përfundojnë auditorët. Vetëdija dhe dukshmëria ishin gjithashtu një problem. Megjithatë iniciativa mbështeti më shumë se 80 vende, ajo nuk ishte shumë e njohur në mesin e vendeve në zhvillim si dhe në BE. Kjo ishte pjesërisht për shkak se veprimet e financuara nuk dalloheshin nga veprimet e tjera të BE-


së që trajtonin ndryshimet klimatike në vendet në zhvillim. Efikasiteti i nismës u ndikua gjithashtu nga kompleksiteti i organizimit të saj, në veçanti dyfishimi i objekteve mbështetëse dhe burimeve të financimit. Informacione të mëparshme Iniciativa e Aleancës Globale për Ndryshimet Klimatike nuk kishte linjën e saj buxhetore në sistemin e kontabilitetit të Komisionit Evropian, por financohej nëpërmjet Instrumentit të Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Fondit Evropian të Zhvillimit. Financimi total i alokuar për nismën ishte 728.8 milionë euro, duke përfshirë kontributet nga vendet e BE-së: 308.8 milionë euro për fazën e parë (2007–2013) dhe 420 milionë euro për fazën e dytë, Aleanca Globale e Ndryshimeve Klimatike Plus (2014–2020). Në vitin 2020, Komisioni vendosi të mos e vazhdojë nismën për një fazë të mëtejshme. Gjatë periudhës 2021–2027, Komisioni do të financojë veprimet për trajtimin e ndryshimeve klimatike në vendet në zhvillim përmes mbështetjes tematike dhe gjeografike nën Instrumentin e Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar.

SADIK MEMUSHI, PRIJËS DHE LUFTËTAR I SHQUAR I LABËRISË



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Fushëbardha është një ndër fshatrat e shquar të Labërisë, por të shquar e bëjnë bijtë e saj që kanë shkruar epepe lavdie shekujve. E gjithë treva historikisht ka qenë djep i mençurisë, trimërisë dhe lavdisë. Hasmit i ka dalë gjithmonë ballazi duke i dalë truallit të të parëve për zot të vatanit. Kështu ka ndodhur gjithmonë në Krahinën e Kardhiqit, në Rrëzomë, në Kurvelesh dhe në gjithë Labërinë, kur kryengritjet dhe kundërshtimi me armë i pushtimit të trojeve të të parëve ka qenë i vendosur, sikurse në vitet 1830-1847 kundër Tanzimatit, por edhe në dekadat që pasuan, më 1854 e më tej, në të gjithë vilajetet ato nuk pushuan dhe nuk reshën kurrë. Bijtë e Labërisë lindën dhe u rritën në këto kryengritje me qindra e mijëra trima mbushën radhët kryengritëse. Historia flet për trimëri të rrallë, kryengritje në jug e në veri me besa-besë që vijuan deri në motin e madh të LSHP, të 1878, të udhëhequr edhe nga Zenel Gjoleka, Çelo Picari e dhjetëra kapedanë të përmendur të historisë. Një ndër më të përmendurit e kohës është trimi dhe prijësi Sadik Memushi, që lindi në Fushëbardhë në zjarrin e luftës për liri në vitin 1830. Oxhaku i familjes Memushi ishte shquar për trimëri dhe mençuri dhe që se kishin lëshuar kurrë jataganin dhe më vonë dyfekun nga supi. Fushëbardha dhe Zhulati në atë periudhë bënë pjesë në nahijen e Delvinës. Sadik Memushi u rrit mes këngësh, tregimesh e legjendash që mëkonin trimërinë dhe burrërinë e fisit të vet dhe të të gjithë fshatit, krahinës dhe Labërisë. Ai u bë krah familjes që i vogël dhe në vatrën e prushit atdhetar u kalit si një luftëtar i së ardhmes dhe që shpejt do të bënte emër dhe do të shquhej dhe për mbrojtjen e Vilajetit nga hordhitë pushtuese, që synonin jugun e Shqipërisë edhe pse ishte ende nën autoritetin e “përkujdesjes” osmane. Ai u rrit me historitë e trimërive të bijve të Fushëbardhës, që kishin rënë në betejat e mëdha të historisë si për Bajo Arif Kazo dhe Habil Shuko Xhuvani, të rënë në Luftën e Meçovës, më 1854 e shumë të tjerë. Por sa herë binte rasti për ta mbrojtur tokën osmane përballë nuk i dilnin turqit, por shqiptarët me vullnetarizëm ose edhe si redifë/rezervistë të ushtrisë osmane. Në luftërat për mbrojtjen e vilajetit kundër armikut që vinte nga toka por dhe na deti bijtë e Labërisë shkruanin faqe lavdie dhe trimërie për



mbrojtjen e truallit të tyre arbëror. Kështu ndodhi edhe kur burrat e Fushëbardhës e Zhulatit por dhe të mbarë Labërisë në Luftën e dytë për Vilajetin e Janinës më 1877-1878, në Qafë Gjashtë, në Palavli, në Skërficë, Senicë. Është mjaft e njohur dhe ka hyrë në librat historiografikë shqiptarë Beteja e Palavlisë, pranë Delvinës, atje ku luftuan trimërisht çeta e udhëhequr nga biri i Fushëbardhës Sadik Memushi. Ai luftoi trimërisht dhe ngeli përjetësisht në fushëbetejë, kur gjakun e derdhi për idealin e shqiptarizmit bashkë me Skëndo Xhuvanit, Myrteza Sullin, Musa Robin, katër trima jelek-zbërthyer. Ata ranë në istikamin e shqiptarizmit, në tokën e të parëve që ua kishin lënë trashëgim. Por sikurse ndodh pas çdo beteje trimat ngelen në këngë: “Kush u hodh proto i pari./Sadik Memushi flamurtari,/topçitë me top ia dhanë,/flaka i mori fustanë./fora e bëri jataganë,/ja të vdekur, ja të gjallë,/gjaku derdhur për vatanë./Skëndua (Xhuvani) me Myrtezanë (Sulli),/Musa Robi deli djalë..”. Katër trimat e Fushëbardhës u përjetësuan në këngë dhe u përcollën me nderime. Organizatori dhe drejtuesi i luftimeve të çetave të Fushëbardhës, Zhulatit dhe fshatrave përreth të Rrëzomës, ishte prijësi, komandanti dhe oratori popullor nga Osman Kuçi nga Fushëbardha. Një këngë tjetër e ngelur

dhe trashëguar në më shumë se një shekull e gjysmë është, një “këngë beteje”: “Topi ra në Palavli./Ra topi në Koqinovë./Palavli shtatë taborë (batalionë),/Ra topi në Palavli./Sadik Memushi pari,..”. Kanë qenë luftime të përgjakshme, ku ka spikatur mençuria e labëve në mbrojtje të amanetit të të parëve. Në betejat e vitit 1878, ndërkohë që Lidhja punonte fuqishëm për organizim politik e ushtarak për të përbashkuar trojet shqiptare të të katër vilajeteve edhe pse Memurët (administratë osmane në trojet tona) bënë gjithçka që të shuanin flakët e kryengritjeve. Një rol të rëndësishëm luajti në betejën e Palavlisë edhe topi i gorictë i përgatitur nga Hito Kongoci, biri i shquar i Fushëbardhës. Hitua me mjeshtërinë e tij e përdori si panik topin e gorictë, në përballjet me armikun, ku edhe sot njihet në Rrëzomë “Maja e Hitos”/“Istikami i Hitos” etj. Ai e përdori këtë për të frikësuar ushtritë greke, për t’i larguar ato nga trojet jugore të vendit. Prandaj edhe kënga i këndohet: “Kush e njeh Hito Fushëbardhë./Ngrehu topin e kalanë./Në kuti ia hodhi zjarrë./E dogji s’u dha i gjallë./Në kala, në Koqinovë./Hito Kongoci me kordhë./Bën dyfek ruan sinorë./... Toka shqiptare në Jug të vendit, në Janinë, në Sarandë, Gjashtë, Lëkurës, Palavli, Bradhomë, Rrëzomë, Luvadh e gjetcë, flet për trimëri të

pashoqe të Sadik Memushit, Skëndo Xhuvanit, Myrteza Sullit, Musa Robit, që sërish për të mësuar më shumë, më gjerë dhe më thellë për historinë, pyesin poetin anonim popullor lab që këndonte: “Gjithë armiqitë le ta dinë,/të shikojnë historinë,/vet koha e ka treguar,/se kushdo që na ka pushtuar,/me lëkurë e ka paguar...” dhe më tej: “Ca burra, ca djem astritë,/me asqerët e osmallisë,/gjyle nga bradhoma nisë./Ndizej flakë gur e lirisë,/që në Livadh e në Delvinë,/nga Fushëbardha u grinë./Në veden të historisë,/Jetën dhanë për Shqipërinë”. Fushëbardha është një fshat me tradita të thella patriotike e luftarake në Labëri, në të cilin gjen me bollëk gjurmë epike, histori, trimëri, këngë, legjenda e tregime që kanë kapërcyer shekujt e kanë ardhur deri në ditët tona, është vendi që ka ushqyer krenarinë labe e kombëtare, vendi i zjarrit gjithmonë të ndezur, vendi ku rinia përkund ëndrrat, ku kujtesa njerëzore e krahinore, nuk harron ngjarjet madhore të të gjitha kohërave, luftërat, gjakun e derdhur për liri, tragjeditë e hallet e kohës, nuk harron, mbi të gjitha, 53 dëshmorët e të gjitha epokave. Shekujt shkuan nëpër luftëra, prandaj kanë një traditë të pasur e të çmuar, sikurse kanë traditë në mençuri, në punë, në kuvende dhe në përballimin e halleve e brengave të jetës. Shtëpitë e saj janë të mbledhura në disa mëhalla

tej e këtej lumit, që e ndan dhe e përbashkon fshatin që shtrihet mes bardhësive, por njihet edhe në Fushëvërrin “Bregu i Memushe”, ku kuvendohej për luftërat, betejat, trimëritë, këngët, hallet e dertet e kohës. Nga ana tjetër, Memushajt kishin lidhje të pandarë me Idriz Ali Dhimën dhe më tej vëllazërinë e Saliut dhe Aliut. Të dhënat në breza flasin për Sali Agaim që kishte një familje të madhe me Memushin, Mullain, Uzeirin, Ahmetin e Brahon, që më vonë u bënë fise më vete dhe që u shquan në historikun e fshatit Fushëbardhë. Mes këtyre kaltërsive dhe bardhësive u lindën e rritën djemtë e fshatit, thurën ëndrrat rinore. Këtu lindën, u rritën dhe luftuan për lirinë edhe biri i shquar Sadik Memushi i parë. Ai është trupëzuar njësh me flamurin e Atdheut, dhe rron në valët e flamurit, duke u shenjtëruar, për veprën trimërore, prandaj respektohet e nderohet në breza. Trimëria e Sadik Memushit nuk ndalet por udhëton nëpër Labëri dhe ka ardhur deri në ditët tona përmes këngëve dhe historisë, sepse ai ra trimërisht në fushën e nderit në moshën 48-vjeçare. Është detyrimi i brezave që të nderojë këtë burrë të madh luftëtar dhe prijës të shquar, që ka ngehur i pavdekur në këngët e popullit. Dëshmorët bënë historinë me gjakun e jetën e tyre, duke falur jetën me vetëdije të thellë atdhetare, por trangu familjar i fisit Memushi është një prej 56 fiseve të Fushëbardhës, është pjesë e ndërjegjegies kombëtare, rezistencës, trimërisë, mençurisë të Fushëbardhës, Cepos, Krahinës së Kardhiqit, Labërisë, është një prej fiseve që me vetitë dhe virtytet e tyre në dekada janë bërë njësh për atdhetarinë dhe kombin. Kohën ndryshuan dhe gjaku i të rënëve u vlerësua me ngritjen e shtetit shqiptar, pasi u vlerësuan dhe po vlerësohen edhe dëshmorët. Ata u vlerësuan por përgatitja dokumentare sipas rregullave dhe procedurave të shtetit është detyrim familjar e shoqëror, është detyrim institucionesh, për të plotësuar e përmbushur kriteret e ligjit nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5 “Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”. Vlerësimi i të rënëve është mision dhe detyrim sublim për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut”, është për të rënë në detyrë në mbrojtje të truallit shqiptar sikurse është edhe Sadik Memushi, që bashkë me bashkëluftëtarët që ra në fushën e nderit në Luftën e Palavlisë, më 1878, meriton të vlerësohet duke u shpallur “Dëshmor i Atdheut”, bashkë me tree bashkëluftëtarët e tjerë nga Fushëbardha që ranë burrërisht në fushëbetejë: Skëndo Xhuvani, Myrteza Sulli, Musa Robi. Nderimi për luftëtarin e spikatur Sadik Memushin është nderim për kombin, sepse duke përjetësuar dëshmorët përjetësojmë kombin shqiptar.

Flamuri kuqezi, që na bashkoi në vitet 1998-1999, na bashkoi në një festë të bukur edhe këto ditë shkurti 2023, në 15-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës.

Janë ushtarakët shqiptarë, të liruar apo në pension, tashmë me banim në Nju Jork dhe Nju Xhersi, të bashkuar në Shoqatën "SKËNDERBEJ", dhe Veteranë të Luftës së UÇK-së të mbledhur në lokalin e atdhetarit Arben Xhambazi në Garefield, NJ, për të festuar këtë ditë të shënuar.

Përhëndet presidenti i Shoqatës, Prof. Asoc. Dr. Gëzim Mustafaj, autor i një libri për luftën e UÇK-së dhe NATO-s, i cili në atë periudhë ka qenë me detyra të rëndësishme në Divizionin e Kukësit, duke përshkruar gjallërisht situatën e atyre ditëve të paharruara.

Moderatorja Dirka Xhakolli i jep fjalën oficerit të lartë të UÇK-së, Astrit Huskajt, tashmë kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së për Amerikën. Astritin, i cili la stetoskopin e mjekut në muajt e asaj lufte, për t'u marrë me punë që as i kish menduar, e thërret zëri i Atdheut, i Kosovës Martire, i dëshmorëve dhe i popullit që po terrorizohej nga bishat serbe, por edhe i tetë pjesëtarëve të familjes së tij, që humbën jetën nën atë terror, kush duke luftuar e kush krejt pa arsye. Ai përshëndet bashkëlufëtarët shqiptarë.

Ndihet i emocionuar për këtë organizim që siç thotë: "Nuk e kam ndeshë në festa dhe tubime të tjera". Sjell përshëndetjet e veteranëve nga Kosova dhe njofton se në mesnatë ka pas një bisedë me Liderët e UÇK-së që mbahen padrejtësisht në Hagë, ku u ka thënë edhe se po përgatitej për veprimtarinë e Shoqatës "SKËNDERBEJ". Por singërisht i keni kaluar pritshmëritë tona me këtë organizim.

Nuk e priste të merrte në duar librin e profesor Gëzim Mustafës, e më tej një libër për Kongresin e Manastirit nga studiuesi Engjëll Zerdëlia, anëtar



NJË FLAMUR QË NA BASHKON

aktiv i Shoqatës sonë.

Autori i këtyre radhëve lexoi një kumtesë për Rolin e faktorit Ndërkombëtar, SHBA-së dhe NATO-s për çlirimin dhe shtetformimin e Kosovës.

Atmosfera festive mes këngëve e valleve, nën kujdesin e DJ, këngëtarit

e recituesit Agim Shiqerukaj, u pasurua nga dollitë dhe përshëndetjet kolegëve tanë, Sulejman Avdia e studiuesit Shefqet A. Saliu, Presidentit të Nderit të Shoqatës Bujar Hasani etj.

Dhe një moment i bukur i improvizuar: Pishtarja e Demokracisë,

Mimoza Ferraj, që vjen nga familje ushtarkësh, bën një lidhje online me ambasadorin, studiuesin dhe personalitetin televiziv, të mirënjohurin Virgjlil Kule, i cili përshëndet festuesit dhe shpreh gëzimin që edhe pse larg, ne jetojmë me ngjarjet në

Shqipëri e Kosovës.

Ishte vërtet një e diel e këndshme, festive e miqësore në këtë ditë historike për Kosovën dhe shqiptarinë, të përbashkuar rreth flamurit kuqezi, rreth Himnit të Tij.

VERI TALUSHLLARI



KORÇA, “PARISI I VOGËL”, HISTORIA E SIMBOLEVE TË QYTETËRIMIT TË HERSHËM

Qytetin e Korçës, në vitet midis dy luftërave botërore e thërrisnin “Paris i vogël”.

Personalitete që e zbukuruan Korçën midis të tjerëve ishin dhe dy kryetarë bashkie, Vasil Avrami, korçar, i cili shtroi rrugët me kalldrëm, bëri kanalizimet e qytetit, solli dritën elektrike dhe krijoi planin urbanistik të Korçës, me sistemin e rrugëve perpendikulare, duke zbatuar rigorozisht ligjin, që asnjë ndërtime të mos bëhej pa lejen përkatëse të bashkisë.

Kryetari tjetër i Bashkisë ishte dibrani Rustem Ymeri, dashamirës i Korçës, i cili i dha qytetit një pamje moderne. Ai shtroi me asfaltin e Serës nga Selenica e Vlorës, dy bulevardet, riorganizoi lulishtet, pyllëzoi rrugët dhe sheshet kryesore, organizoi shpërndarjen e profesioneve në treg dhe sistemoni rrugët e Pazarit...



ujë të pijshëm furnizuan edhe një pjesë të qytetit. Dy vjet më pas, më 1931, filloi prodhimi. Fabrika u pajis me makineri të kohës, të cilat kryenin të gjitha proceset që nga përpunimi i elbit e deri te kthimi i tij në lëng, mbyllur në shishe të vogla dhe të mëdha. Çdonjëra prej shisheve ishte kënaqësi e veçantë dhe po aq e mirë sa ajo e fabrikave të birrës në Gjermani. Por prapë birra “Korça” mbetej e veçantë, pasi siç thuhej, për prodhimin e saj përdorej diçka natyrale që mbahej sekret. Birra “Korça” ishte e pasur në vlera ushqyese, e shëndetshme dhe nuk kishte alkool. Në atë kohë thuhej: “Një shishe birre “Korça” është sikur të kesh ngrënë një drekë”. Birra nuk konsiderohej si pije luksi; ishte pija e të gjithëve. Në ato kohëra fusha e Korçës mbillej me elb.



Që nga dita e parë e prodhimit të birrës, viti 1929, deri në dhjetor të vitit 1933, shoqëria “Birra Korça” nuk pati detyrime ndaj shtetit me qëllim fuqizimin e saj. Regjistrimi i shoqërisë u bë në Odën ekonomike të Korçës, më 18 dhjetor 1933: “Në bazë të shkresës nr. 2215 datë 18.12.1933 të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, me anë të së cilës urdhërohet transkriptimi i kopjes së aktit konstitues të shoqërisë anonime “Birra Korça” në regjistrin e tregtisë konform nenit 11 të Kodit Tregtar në fuqi, vërtetohet se akti konstitues i shoqërisë anonime “Birra Korça” i homologuar prej Gjyqit Kolegjial të Korçës (dega tregtare) me vendim nr 1, datë 8 nëntor 1933, u transkriptua në radhorin e posaçëm të odës së Tregtisë së Korçës me Nr. 1, datë 18 dhjetor 1933.”

“Birra Korça” mund të furnizonte gjithë Shqipërinë. Shoqëria punësoi 220 shqiptarë dhe 25 specialistë italianë; kujdesej për çdo gjë që i përkiste shëndetit të punonjësve dhe sigurimit të jetës së tyre. Ndërsa për t’u ardhur në ndihmë fermerëve ngritën dhoma frigoriferike për prodhimet e qumështit. Për herë të parë kjo gjë ndodhi në Korçë. Fabrika u bë e njohur edhe për prodhimin e ujit “Kristal”.

Korça, “kryeqyteti i industrisë” shqiptare

Fabrika e trikotazhit, risia teknologjike që u soll në Korçë, dhe e cila prodhoi veshmbathje për gjithë Shqipërinë, ishte ide fantastike, por ajo duhej materializuar. Dhe sigurisht duheshin blerë makineritë. Nazima Ypi, e cila ishte specializuar në Gjermani për tekstilet e trikotuara, bleu makineritë e para në vendin perëndimor. Në fillim ato ishin manuale dhe më pas u zëvendësuan me makina moderne. Kapitalin fillestar e siguruan nga shitja e pronave të Ali Alizotit dhe Nazima Ypit. Fillimisht fabrika do fillonte veprimtarinë para shtëpisë së Memeda Shtyllës dhe më vonë në ndërtesën e Sabri Qytezës. Më pas u ndërruan në disa vende të tjera.

Për të punuar u zgjodhën disa teknologë të njohur dhe u përzgjedhën zonjushat e ardhura nga Greqia madam Gjylatër zonja Dikrani, zonjushat Agavni, Siranush (bija e madam Gjylatërit, modeliste) etj. Zonjat në fjalë ishin me origjinë nga krahina e prodhimit të sixhadeve të Armenisë.

Fillimisht filluan të prodhoheshin sixhade. Por tregtia e sixhadeve në atë kohë nuk ecte dhe u mbyll.


Rreth viteve 30’, po në Korçë, Nazima Ypi krijoi edhe një fabrikë tjetër trikotazhi me Fadil Garon dhe Ismail Kapshticën, meqenëse linja e sixhadeve nuk e pati suksesin e pritur.

Ndërkohë Madam Gjylatëri, u caktua mësuese në “Shkollën Qytetëse të Vajzave” në Korçë. Këtu ajo përgatiti dhjetëra kuadro, të cilat punuan më pas si specialiste në punishten e sixhadeve të Korçës që drejtohej nga Garo Avakian, pinjoll nga familjet armenë të sjella për fabrikën e trikotazheve.

Fabrika kishte ngritur një dyqan shitje në Tiranë në kompleksin tregtar “Vllazën Juma”, në Rr. 28 Nëntori (që u dogj

gjatë luftës së Tiranës, nëntor 1944) dhe një tjetër dyqan luksoz në Vlorë, që administrohej nga Ahmet Nurja.

Në bazë të një dekreti të posaçëm, të nxjerrë në vitin 1947 nga presidenti i R.P të Shqipërisë, pa asnjë shpërblim, fabrika në Tiranë u shtetëzua.



Ishte pikërisht kjo fabrikë që do të përgatiste plejadën e qindra punëtorëve të specializuar për të punuar në trikotazh dhe në saje të kësaj tradite kjo industri funksionoi deri vonë.

Fabrika e trikotazheve të Korçës gjatë kohës së diktaturës ishte një nga më të njohurat dhe me famë në gjithë Shqipërinë.

Fabrika e birrës “Korça”, industria e dytë e cila lartësoi emrin e mirë që kishte Korça

Ndërsa Bashkia hartonte planin urbanistik të Korçës, Selim Mborja dhe italiani Umberto Uberti projektuan ngritjen e një fabrike të madhe birre në qytetin e Korçës. Ndërtimi i fabrikës nisi në vitin 1929. Ujin e sollën nga mali i Moravës, madje me

